

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5550  
E hënë, 13 gusht 2018  
çmimi 0.40 €

## Thaçi: Dialogu duhet të mbyllet me njohje reciproke

Presidenti Hashim Thaçi ka debatuar përmes rrjetit social "Twitter" me Carl Bildt dhe Daniel Serwer për korrigjimin e kufijve



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

#### ADEM DEMAÇI, 'I DËRGUARI I ZOTIT PËR SHPËTIMIN E KOSOVËS...!' F. 11

ESSAT H. BILALI

#### KAOSI DHE IKJA NGA PËRGJEGJËSIA POLITIKE F. 11

Blerim CANAJ



#### MINISTRI GASHI: POLICIA DO TË JETË E PAKOMPROMIS NDAJ SHKELËSVE NË TRAFIK F. 11

### EKONOMI

#### BQK-ja: SHKALLA E RITJES EKONOMIKE ËSHTË LUHATUR RRETH NORMËS 3.5 PËR QIND F. 8

#### 'TREPÇA' E NDARË, ASNJË KOMUNIKIM ME MENAXHMETIN NË PJESËN VERIORE F. 9

### KULTURË

#### HAPET EKSPONIZATA FOTO GRAFIKE 'UNË JAM SHQIPTAR'

### SPORT

#### MKRS-ja DHE FFK-JA: EJANI TA NDEROJMË LEGJENDËN FADIL VOKRRI F. 18

#### RASHICA: DUA TË BËHEM IDHULL PËR FËMIJËT E KOSOVËS F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", ISMAJL KURTESHI

FAQE 4-5

## Ideja për korrigjimin e kufirit, e rrezikshme

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, është shprehur kundër idesë për korrigjimin e kufirit me Serbinë.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ideja për korrigjimin e kufirit apo loja me Luginën e Preshevës është shumë e rrezikshme dhe duhet të pengohet.


Kurteshi i ka bërë thirrje Kuvendit që në shtator të marrë vendime të duhura karshi kësaj situatë, në të kundërtën ka thënë se qytetarët duhet të dalin në mbrojtje të republikës. Kurteshi ka vlerësuar se vendit po i kanoset rreziku i ndarjes, prandaj ka paralajmëruar mbajtjen e protestave në shtator. Ai ka thënë se qytetarët nuk do të lejojnë as autonomi për veriun dhe as ndarje të Kosovës

## Të rinjtë: BE-ja t'ia hapë dyert Kosovës

Në Ditën Botërore të Rinisë të rinjtë e Kosovës kanë marrë mbështetje nga institucionet qendrore të vendit. Derisa disa prej ministrive kanë mbajtur aktivitete konkrete për ndër të kësaj dite, udhëheqësit institucionalë janë zotuar se do të krijojnë më shumë mundësi rreth punësimit të të rinjve. Në kuadër të Ditës Botërore të Rinisë, Ministria e Kulturës së bashku me dy organizata joqeveritare kanë organizuar një performancë artistike ku është kompletuar flamuri i BE-së me mesazhin që Kosova është gati për liberalizimin e vizave



### Qeveria mohon se asociacioni do të ketë kompetenca ekzekutive



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Basha: Qeveria ka braktisur të rinjtë shqiptarë

TIRANË, 12 GUSHT - Në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka zgjedhur "Twitter"-in për ta përcjellë mesazhin e tij për të rinjtë shqiptarë.

Basha rikonfirmoi mbështetjen e PD-së për rininë, duke premtuar se do t'i ulë tarifën e universiteteve

dhe do të ofrojë stazh pune me pagesë për studentët kur të vijë në pushtet.

"Në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, rikonfirmoj mbështetjen e Partisë Demokratike për rininë, duke përfshirë uljen e tarifave universitare dhe stazh vjetor pune me pagesë për studentët", shprehet

Basha. "Shqipëria zë vendin e parë në Evropë për papunësinë. 300 mijë të rinj shqiptarë janë pa punë. 133 mijë të rinj kanë braktisur shkollat në katër vjet. Zero lekë nga qeveria për mbështetjen e rinisë. 70% e të rinjve kërkojnë të largohen nga Shqipëria drejt BE-së", shprehet kryetari i PD-së.

Gjithashtu, Basha shton se "Shqipëria zë vendin e parë në botë për përdorimin më të lartë të kokainës për të rinjtë". Gjithashtu, kreu i opozitës nuk ngurroi ta akuzojë qeverinë Rama se ka braktisur rininë e vendit, duke mos shpenzuar asnjë lekë për këtë kategori të popullsisë.



## Nurellari: Debati për korrigjim të kufijve po fryhet tepër

"Po ta dëgjosh deklaratën e Thaçit, duket se do të bëhet një marrëveshje mes Serbisë dhe Vuçiqit, ku Kosova do të marrë, por nuk do të humbë. Madje Thaçi ka shkuar deri atje sa ka thënë se edhe nëse marrëveshja nuk realizohet, ai ka një plan B që qëndron vetëm në kokën e tij", ka thënë Nurellari



PRISHTINË, 12 GUSHT - Ish-këshilltari i presidentit Hashim Thaçi, tani këshilltar i kryeparlamentarit Kadri Veseli, Adri Nurellari, ka thënë se debati rreth idesë për korrigjimin e kufijve është duke u fryrë së tepërmi. "Po ta dëgjosh deklaratën e Thaçit, duket se do të bëhet një marrëveshje mes Serbisë dhe Vuçiqit, ku Kosova do të marrë, por nuk do të humbë. Madje Thaçi ka shkuar deri atje sa ka thënë se edhe nëse marrëveshja nuk realizohet, ai ka një plan B që qëndron vetëm në kokën e tij", ka thënë Nurellari. Sipas tij, Kosova është duke përmbushur marrëveshjet e nënshkuara me Serbinë dhe se veriu i saj është i përfshirë në jetën politike e institucionale të vendit.

Në këtë kontekst, ai ka thënë se është iluzion të mendohet që drejtuesit e saj po kërkojnë kthim mbrapa. "Për t'i vënë fre një përpjekjeje që po bën pala serbe për të

përfshirë si pjesë të dialogut shkëputjen e një territori të Kosovës. Ajo kërkon të bëhet presion ndaj Beogradit që ta pranojë Kosovën kështu siç është", ka thënë Nurellari.

Ndërsa për analistin Andi Bushati presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka diçka që po mban në errësirë. "Qëndrimeve të Thaçit u duhet thënë një jo e prerë. Duket sikur e gjithë klasa politike sot në Kosovë dhe Shqipëri është në terr të plotë dhe Hashim Thaçi hedh pak nga pak ndonjë copëz për të

bërë komunikimin e tij me publikun. Ne nuk mund të përfshihemi në një proces të tillë pa ditur se deri ku mund të shkohet dhe pa vendosur kornizat e kuqe se deri ku mund të negociohet", ka thënë Bushati.

Ndërsa ish-ministri i Jashtëm shqiptar, Tritan Shehu, thotë se tezat për korrigjim apo ndryshim kufijsh nuk flasin për të ardhmen, por për të shkuarën. "Ne jemi për t'i zhvleftësuar kufijtë në rajon në këto momente, duke implementuar ligjet e rregullat e BE-së.

Nesër do t'i zhdukim kufijtë duke qenë të gjithë në BE", tha Shehu. Teza e Thaçit, e cila gjithsesi nënkupton ndryshimin e hartës së shtetit të pavarur të Kosovës, do të ishte kundërvënie ndaj partnerëve evropianë e amerikanë, që u investuan për këtë shtet.

Rusia dhe Turqia, sipas ish-ministrit të Mbrojtjes, Fatmir Mediu, po shtojnë ndikimin në Ballkan, që nuk është më në vëmendjen e BE-së apo ShBA-së si më parë, kur Shqipëria u anëtarësua në NATO apo Kosova fitoi pavarësinë.

"Do të thosha se shqiptarët janë sot në një situatë më të rrezikshme të mundshme, që kanë qenë ndonjëherë në historinë e pas viteve '90, apo pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës", tha Mediu.

Ndërkaq Michael Leigh, ekspert për politikën evropiane, ka thënë se Bashkimi Evropian nuk i ka ndryshuar politikën që mbështet integritetin territorial të Kosovës. Ai ka thënë se është e pamundur që BE-ja të jetë pro ndryshimeve të statusit quosë territoriale.

## Osmani organizon përvjetorin e Marrëveshjes së Ohrit

SHKUP, 12 GUSHT - Ndryshe nga tradita e deritanishme kur zëvendëskryeministri për Marrëveshjen e Ohrit ishte organizator i manifestimeve për shënimin e Marrëveshjes së Ohrit, në këtë përvjetor zëvendëskryeministri për Marrëveshjen e Ohrit, Hazbi Lika, nuk duket askund. "Alsat

M" kontaktoi Likën për të kërkuar sqarim, por ky i fundit ishte i pakapshëm. Këtë vit manifestimin kryesor do ta organizojë Sekretariati për Çështje Evropiane, në krye me zëvendëskryeministrin Bujar Osmani, që do ta ketë moton "Ruga për në Bruksel përmes Ohrit". Lideri i BDI-së, Ali

Ahmeti, hodhi poshtë zërat për mosmarrëveshje brendapartake, duke e arsyetuar moton e manifestimit të nesërm si adekuate pasi, sipas tij, vendi ndodhet në prag të anëtarësimit në NATO dhe BE. "Aspak nuk ka mosmarrëveshje partiake dhe unë më duket se që në fillim e shpjegova moton, sepse është

momenti i tillë që ky organizim të bëhet nga zëvendëskryeministri për eurointegritet, sepse motoja e këtij viti është "Ruga për në NATO dhe për në BE kalon nëpër Ohër", tha Ali Ahmeti.

Megjithëse kanë mbetur pezull shumë pika të kësaj marrëveshjeje kornizë, si: çështja e gjuhës

shqipe apo sistematizimi i administratorëve, për Ahmetin Maqedonia, pos që është më ndryshe pas 2001-shit, tani mund të merret model nga vendet e tjera që kanë kriza dhe çështje për të zgjidhur. Ahmeti tha se po punohet edhe për zgjidhjen e statusit të ish-ushtarëve të UÇK-së.



Vazhdon debati në mes të institucioneve të vendit dhe opinionit publik rreth kompetencave të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

# Qeveria mohon se asociacioni do të ketë kompetenca ekzekutive

Qeveria e Kosovës ka kundërshtuar pretendimet e shumta se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të ketë kompetenca ekzekutive. Koordinatorin Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka bërë me dije se statuti i asociacionit do të jetë vetëm sipas rekomandimeve të Gjykatës Kushtetuese. Mirëpo analistët politikë janë shprehur të bindur se asociacioni do të ketë kompetenca ekzekutive të cilat po kërkohen nga serbët

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 12 GUSHT - Qeveria e Kosovës ka mohuar se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të ketë kompetenca ekzekutive, kurse analistët politikë janë shprehur të bindur se asociacioni do të jetë nivel i tretë i pushtetit.

Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka përjashtuar çdo mundësi që asociacioni të jetë nivel i dytë rajonal në sistemin politik dhe qeverisës të vendit. "E para, në Kosovë të gjitha institucionet e shtetit e kanë për obligim t'i marrin për bazë rekomandimet e Gjykatës Kushtetuese. Si rrjedhojë, Statuti i Asociacionit duhet t'i reflektojë rekomandimet dhe t'i marrë për bazë udhëzimet e Kushtetueses. Në të njëjtën kohë, Qeveria do të jetë e qartë duke mos lejuar që Asociacioni të ketë kompetenca ekzekutive, në të njëjtën kohë duke mos lejuar nivel të dytë rajonal në sistemin politik dhe qeverisës të vendit", ka thënë Tahiri, duke përmendur që askund në botë nuk ka një praktikë që Asociacioni i Komunave të ketë përgjegjësi mbi arsimin e lartë apo fushave të tjera vitale. "Kjo do të thotë se një kërkesë e tillë nga Beogradi është një lojë që për qëllim ka ta paraqesë Kosovën keq para faktorit ndërkombëtar, pse jo edhe ta shtyjë themelimin e këtij Asociacioni me synim që të nxitë ndonjë projekt tjetër politik!", është shprehur Tahiri.

Ai ka vlerësuar se logjika e asociacionit nuk është strehë

nacionalizmi, por instrument për demokratizim dhe integrim. "E treta, sa i përket funksionimit dhe organizimit të qeverisjes lokale në përgjithësi, me theks tek asociacionet e komunave, definitivisht Serbia nuk ka as shembuj e as praktika të mira në këtë fushë.

Atje edhe më tutje komunat nuk kanë ndonjë rol në fuqizimin e demokracisë së drejtpërdrejtë, autonomisë fiskale e as në aspektet e shërbimeve dhe atyre zhvillimore. Krejt në fund, logjika e Asociacionit nuk është strehë nacionalizmi, por instrument për demokratizim dhe integrim", ka deklaruar Tahiri.

Edhe presidenti Hashim Thaçi është shprehur i bindur disa herë se asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive. Por, ndryshe mendojnë njohësit e rrethanave politike.

Behxhet Shala dhe Imer Mushkolaj kanë bërë me dije për gazetën "Epoka e re", se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe nuk do të jetë sipas mendimit të Gjykatës

Kushtetuese. Sipas tyre, edhe propozimet e presidentit Thaçi për bashkim të Luginës së Preshevës me Kosovën përmes korigjimit të kufirit me Serbinë po bëhen me qëllim që sa më lehtë të pranohen kompetencat ekzekutive të asociacionit. "Asociacioni është i rrezikshëm për faktin se do të ketë kompetenca ekzekutive dhe, si i tillë, do të jetë një pushtet i tretë. Ndonëse këta po thonë se nuk do të ketë kompetenca të tilla, po e shohim se serbët dhe bashkësia ndërkombëtare as që po i marrin parasysh vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese. Ndërsa ne për konsum të brendshëm po i tregojmë muskujt duke deklaruar se Kushtetuesja do të jetë ajo e cila do të vendosë në fund për asocia-

cionin", është shprehur analisti politik Behxhet Shala.

Njohësi tjetër i rrethanave politike, Imer Mushkolaj, beson se kompetencat ekzekutive të këtij asociacioni tashmë janë kryer. "Thaçi ka ndërmarrë këtë ofensivë mediatike për të folur rreth korigjimit të kufijve para vazhdimit të fazës finale të dialogut në Bruksel dhe para themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, që do të jetë një trupë autonome me kompetenca ekzekutive brenda vendit. Në këtë mënyrë, Thaçi po përpiqet ta neutralizojë dëmin që do t'i bëhet vendit, duke i thënë veriut praktikisht një autonomi dhe duke rrezikuar që Kosovën ta kthejë në një shtet jofunksional", ka thënë Mushkolaj.



## Gjendet një mjet i dyshuar i pashpërthyer në Klinë

KLINË, 12 GUSHT - Në fshatin Poterq i Epërm të Klinës është gjetur një mjet i dyshuar. Njësitë policore kanë siguruar vendin për të punuar me ekskavator në

mënyrë që të shihet se për çfarë bëhet fjalë. Njësitë për Çminim të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), siç ka njoftuar policia, në mënyrë të sigurt kanë bërë tërhe-

qjen e mjetit të dyshuar në gjatësi prej 30 centimetrash që dyshohet se ka mbetur nga Lufta e Dytë Botërore. Mjeti është marrë me vete për t'u ekzaminuar.



Flet për "Epokën e re", Ismajl Kurteshi

# Ideja për korrigjimin e



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, është shprehur kundër idesë për korrigjimin e kufirit me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ideja për korrigjimin e kufirit apo loja me Luginën e Preshevës është shumë e rrezikshme dhe duhet të pengohet. Kurteshi i ka bërë thirrje Kuvendit që në shtator të marrë vendime të duhura karshi kësaj situate, në të kundërtën ka thënë se qytetarët duhet të dalin në mbrojtje të republikës. Kurteshi ka vlerësuar se vendit po i kanoset rreziku i ndarjes, prandaj ka paralajmëruar mbajtjen e protestave në shtator. Ai ka thënë se qytetarët nuk do të lejojnë as autonomi për veriun dhe as ndarje të Kosovës

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 12 GUSHT - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, ka thënë të dielën se ideja për korrigjimin e kufirit me Serbinë është shumë e rrezikshme dhe duhet të pengohet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se një gjë e tillë duhet të parandalohet

ose përmes vendimeve të Kuvendit ose përmes protestave të qytetarëve. "Ideja për korrigjimin e kufirit apo loja me Luginën e Preshevës është shumë e rrezikshme dhe duhet të pengohet. Ajo që po bën presidenti Hashim Thaçi është e patolerueshme dhe e dëmshme, prandaj duhet të pengohet nga institucionet e Kosovës dhe nëse kjo është e pamjaftueshme, duhet të pengohet edhe nga

qytetarët përmes protestave", është shprehur Kurteshi, duke shtuar se vendit po i kanoset rreziku i ndarjes. Në këtë kontekst, ai ka paralajmëruar fillimin e protestave në muajin shtator. Pavarësisht prej pretendimeve të Serbisë dhe lëshimeve të presidentit Thaçi në dëm të vendit, Kurteshi ka thënë se qytetarët nuk do të lejojnë as autonomi për veriun dhe as ndarjen e Kosovës. "Kam besuar se Kosova do të çlirohet nga Serbia atëherë kur Serbia ka qenë shumë e fortë dhe ne kemi qenë mjaft të dobët. Kurse tani gjasat janë shumë më të mëdha dhe është shumë më lehtë ta mbrojmë Kosovën nga ndarja ose nga lojërat që po quhen korrigjim i kufirit. Jemi të vendosur të mos lejojmë ndarjen e Kosovës dhe autonominë e veriut", ka deklaruar ai.

**"Epoka e re":** Z. Kurteshi, cili është qëndrimi i Lëvizjes Vetëvendosje lidhur me idenë e presidentit Hashim Thaçi për korrigjimin e kufirit me Serbinë?  
**Kurteshi:** Ose nuk po shoh mirë

ose puna nuk është mirë. Kam dëshirë me qenë e para por, fatkeqësisht, është e dyta. Ideja për korrigjimin e kufirit apo loja me Luginën e Preshevës është shumë e rrezikshme dhe duhet të pengohet. Presidenti nuk e ka ndërmend të heqë dorë nga aventurat e filluara në vitin 2011 me bisedimet teknike, pastaj me bisedime politike dhe tash me korrigjim terriroresh që në një farë mënyre ka qenë vijë e kuqe nga të gjitha institucionet e Kosovës.

**"Epoka e re":** Do të thotë nuk e përkrahni këtë ide dhe e konsideroni të rrezikshme?

**Kurteshi:** Së pari, nuk e përkrahim idenë që një person të silltet sikur Kosova të jetë çifligu i tij, duke luajtur me bisedime, kufij dhe me çdo gjë. Kosova është e qytetarëve dhe secili që flet me Serbinë duhet ta ketë autorizimin nga organet kompetente, në këtë rast nga Kuvendi i Kosovës. Ajo që po bën presidenti Hashim Thaçi është e patolerueshme dhe e dëmshme,

prandaj duhet të pengohet nga institucionet e Kosovës dhe nëse kjo është e pamjaftueshme, atëherë duhet të pengohet edhe nga qytetarët përmes protestave.

**"Epoka e re":** Kur do të fillojë mbajtja e këtyre protestave?

**Kurteshi:** Nuk kemi kurrgjë të detajuar sepse në korrik dhe gusht qytetarët janë nëpër pushime. Mirëpo shtatori është koha kur konsiderojmë se duhet të organizohemi dhe të kërkojmë nga Kuvendi që të marrë vendime të duhura, dhe nëse ato nuk janë të mjaftueshme, atëherë natyrisht se do t'u drejtohem qytetarëve me kërkesën që ata të dalin në mbrojtje të republikës.

**"Epoka e re":** Idesë për korrigjimin e kufirit po i referoheni si lojë. A do të thotë kjo se është e pamundur që Lugina t'i bashkohet Kosovës?

**Kurteshi:** Nuk po them se nuk ka gjasë, por me këto çështje ka njëfarë rendi që duhet të respektohet. Në këtë rend puna e parë që

# kufirit, e rrezikshme

Thaçi ka biseduar me Serbinë jo si dy shtete të pavarura dhe për marrëdhëniet në mes të dy popujve, por për rregullimin e brendshëm të Kosovës që është shkelje e Kushtetutës së Kosovës. Kjo është arsye e mjaftueshme që Kuvendi t'i fillojë procedurat për shkarkimin e Hashim Thaçit nga posti i presidentit.

**"Epoka e re":** Do të inicioni ju si Vetëvendosje një gjë të tillë?

**Kurteshi:** Nuk kemi biseduar në detaje, mirëpo personalisht dy herë kam dalë publikisht me shkrime dhe me idenë se duhet të fillojë kjo procedurë dhe ajo nuk është kundërshtuar nga askush. Mbetet të shihet se çfarë do të ndodhë në shtator kur ta fillojë punën Kuvendi i Kosovës. Sidoqoftë, nuk mund të jemi indiferentë në situatën kur vendit po i kanoset rreziku i ndarjes.

**"Epoka e re":** Me këtë format të dialogut nën drejtimin e presidentit Thaçi sa ka gjasë që Lugina e Preshevës t'i bashkohet Kosovës, apo kjo çështje do të mbetet vetëm në nivel të deklaratave?

**Kurteshi:** Dialogu po ndodh pa format. Dialogu po zhvillohet nga një person i paautorizuar sepse askush nuk i ka dhënë të drejtë Hashim Thaçit ta vazhdojë dialogun në emër të Kosovës. Rezoluta e Kuvendit të Kosovës, e cila e ka autorizuar Qeverinë e Kosovës ta udhëheqë dialogun në kohën kur ka qenë Hashim Thaçi kryeministër, ende është në fuqi, sepse atë rezolutë nuk e ka shfuqizuar askush. Thaçi më nuk është kryeministër, prandaj nuk i takon atij ta udhëheqë dialogun. Dialogun ose duhet ta udhëheqë Qeveria ose Kuvendi

duhet të miratojë një rezolutë tjetër me të cilën do ta përcaktojë së pari formatin e bisedimeve edhe rendin e ngjarjeve, pastaj delegacionin, në fund edhe kryesuesin e delegacionit. Tek pastaj vijnë kërkesat me radhë të përcaktuara nga institucionet e Kosovës dhe jo një individ që sillet sikur të ishte pronar i Kosovës.

**"Epoka e re":** Cili do të jetë epilogu i këtij dialogu pa mbështetjen e opozitës dhe pa arritjen e një konsensusi nacional?

**Kurteshi:** Ky dialog është ilegal. Nuk është dialog në mes të Kosovës dhe Serbisë, mirëpo është dialog në mes të Thaçit dhe Serbisë. Prandaj, si i tillë, nuk ekziston dialog në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ky dialog është ilegal nga i cili Hashim Thaçi duhet të heqë dorë menjëherë.

**"Epoka e re":** Do të jetë i dëmshëm për Kosovën përfundimi i këtij procesi?

**Kurteshi:** Ky proces është i dëmshëm për Kosovën dhe do të bëjmë përpjekje ta evitojmë një gjë të tillë duke marrë vendime Kuvendi në shtator. Nëse kjo nuk mjafton, atëherë do t'i thërrasim qytetarët që të dalin në mbrojtje të republikës dhe përmes protestave ta kërkojnë mënjanimin e një presidenti të papërgjegjshëm.

**"Epoka e re":** Do të kenë efekt këto protesta?

**Kurteshi:** Jam shumë i sigurt se protestat do të kenë efekt sepse ata që duan ta shpëtojnë vendin nga një dëm tepër i madh do të jenë në rrugë. Në Kosovë pak ka njerëz që nuk u intereson fati i

vendit, përveç minoriteti serb i cili është i interesuar që Kosova të mbetet nën Serbi apo së paku një pjesë e saj të ndahet dhe t'i bashkohet Serbisë.

**"Epoka e re":** Në opinion këto ditë është përfolur mundësia që nga dialogu veriu do të përfitojë një lloj autonomie. Është i realizueshëm një opsion i tillë?

**Kurteshi:** Me udhëheqje të papërgjegjshme të dialogut sikur kjo që e kemi ka gjasë të ndodhë gjithçka, por mendoj se me qytetarë aktivë këto gjëra do të pengohen dhe Kosova nuk do të ndahet. Serbët e Kosovës që i kanë të gjitha të drejtat, madje janë edhe të privilegjuar, nuk mund të pretendojnë ndonjë autonomi sepse nuk i kanë as pesë për qind të popullatës. Ata duhet t'i kenë të drejtat që u takojnë me Kushtetutë, madje Kushtetuta u garanton shumë më shumë sesa që ata kanë nevojë, mirëpo kjo çështje është rregulluar me Pakon e Ahtisarit. Të gjithë duhet të angazhohemi për ta parandaluar një katastrofë të madhe që Serbia po mundohet t'ia sjellë Kosovës.

**"Epoka e re":** Mund të parandalohet ndarja apo autonomia e veriut?

**Kurteshi:** Kam besuar se Kosova do të çlirohet nga Serbia atëherë kur Serbia ka qenë shumë e fortë dhe ne kemi qenë mjaft të dobët. Kurse tani gjasat janë shumë më të mëdha dhe është shumë më lehtë ta mbrojmë Kosovën nga ndarja ose nga lojërat që po quhen korrigjim i kufirit. Jemi të vendosur të mos lejojmë ndarjen e Kosovës dhe autonominë e veriut.

duhet të ndodhë është që Serbia ta njohë pavarësinë e Kosovës për të cilën z. Thaçi ka deklaruar me dhjetëra herë se Serbia e ka njohur Kosovën, por kjo nuk është e vërtetë. Gjatë tërës kohës

## Ministri Gashi: Policia do të jetë e pakompromis ndaj shkelësve në trafik

PRISHTINË, 12 GUSHT - Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka bërë me dije të dielën se shtimi i pranisë policore në komunikacionin rrugor me automjete civile është pjesë e vendimit që ka marrë për ndërmarrjen e masave emergjente, për ruajtjen dhe mbrojtjen e sigurisë në trafik. "Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Policinë e Kosovës do të jetë e pakompromis ndaj shkelësve në trafik", ka thënë ministri Gashi. Me qëllim të ngritjes së sigurisë në trafikun rrugor, ministri Gashi më 3 gusht ka nënshkru-

ar vendimin për ndërmarrjen e masave emergjente për ruajtjen dhe mbrojtjen e sigurisë në trafik. Sipas këtij vendimi, i cili do të mbetet në fuqi deri më 1 tetor, Policia e Kosovës do t'i ndërmarrë të gjitha masat në pajtim me ligjin në fuqi, për të siguruar që në të gjitha rastet e punimeve në rrugë janë duke u zbatuar masat e sigurisë të ndërlidhura me komunikacionin rrugor; Policia e Kosovës do të ndërmarrë masa alternative me qëllim të ruajtjes së sigurisë në trafikun publik, përfshirë edhe ndalimin e patentshoferit sipas ligjit në

fuqi të atyre që rrezikojnë trafikun publik, për një afat të caktuar deri në zbatimin e procedurave të përcaktuara me ligjet në fuqi.

Po në vendim thuhet se Policia e Kosovës ta shtojë praninë policore në komunikacionin rrugor, në mënyrë specifike do ta shtojë numrin e patrullave me automjete të pashënjestruara (civile). Ndërkaq në rastet kur ka kundërvajtje që shkaktojnë rrezik në komunikacionin rrugor të kryera nga shtetasit e huaj, duhet të njoftohen autoritetet e shteteve përkatëse prej nga vijnë këta kundërvajtës.





Presidenti Hashim Thaçi ka debatuar përmes rrjetit social "Twitter" me Carl Bildt dhe Daniel Serwer për korrigjimin e kufijve

## Thaçi: Dialogu duhet të mbyllet me njohje reciproke

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, gjatë një debati që ka pasur në rrjetin social "Twitter" me Carl Bildt dhe Daniel Serwer rreth idesë së korrigjimit të kufirit me Serbinë, ka theksuar se është në favor të arritjes së demarkimit paqësor të kufirit prej 400 kilometrash në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Një marrëveshje e balancuar është në interesin e të gjithëve, përfshirë ShBA-në e BE-në", ka thënë Thaçi



me aleatët kryesorë të Kosovës. "A dëshironi vërtet të hapni për rinegociim marrëveshjen me ShBA-në dhe shumicën e vendeve të BE-së që i kanë dhënë njohje vendit tuaj? Kjo mund të përfundojë shumë keq", ka pyetur Serweri. Ndaj pyetjes së Serwerit, presidenti Thaçi ka dhënë këtë përgjigje: "I dashur Daniel Serwer, jam i përkushtuar thellësisht ta arrijmë anëtarësimin e Kosovës në NATO

dhe BE. Bazuar në vlerat e përbashkëta që ndajmë. Bazuar në nevojën për të arritur siguri për fëmijët tanë. Duhet ta mbyllim kapitullin i cili do të sjellë njohje reciproke dhe marrëdhënie të mira ndërfaqjësore në mes të Kosovës dhe Serbisë", është përgjigjur Thaçi. Më tutje, Thaçi ka thënë se është kundër çfarëdo ndaje të Kosovës. "Jam kundër ndarjes, jam kundër

shkëmbimeve, jam kundër status qos, jam kundër krijimit të një Republika Srpska në Kosovë. Por, jam në favor të arritjes së demarkimit paqësor të kufirit prej 400 kilometrash në mes të Kosovës dhe Serbisë. Një marrëveshje e balancuar është në interesin e të gjithëve, përfshirë ShBA-në dhe BE-në", ka shkruar Thaçi në "Twitter", duke komunikuar me Serwerin.

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 12 GUSHT** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka shfrytëzuar rrjetin social "Twitter" për të hyrë në debat me dy nga njohësit më të mirë të situatës në Ballkan, ish-kryeministrin e Suedisë, Carl Bildt dhe analistin amerikan Daniel Serwer, në lidhje me idenë për korrigjim të kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Fillimisht, presidenti Thaçi i është përgjigjur një shkrimi të Bildtit ku ai pohon se nuk duhet bërë shkëmbime terri-torësh, por autonomi për serbët e Kosovës si marrëveshje finale me Serbinë. "I dashur Carl Bildt, unë jam i përkushtuar në rrugën tonë drejt NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Ne duhet ta arrijmë njohjen reciproke dhe raporte të fqinjësisë së mirë në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe gjithash-

tu ta arrijmë paqen. Marrëveshja për demarkimin e kufirit do të garantojë multietnicitetin tonë. Vonesat do të na kushtonin shumë", ka shkruar Thaçi në "Twitter".

Ky status i Thaçit ka ndikuar që ish-kryeministri suedez t'i përgjigjet presidentit të Kosovës, duke thënë se "pajtohet me Thaçin". "Pajtohem. Është e domosdoshme të lëvizet përpara. Është në interesin e Kosovës dhe Serbisë perspektiva e integritetit në Bashkimin Evropian dhe institucione euroatlantike, duke mbrojtur kufijtë, interesat e përbashkët dhe karakterin shumetnik të rajonit", ka shkruar Bildt. Po ashtu, presidenti Thaçi ka qenë aktiv edhe në komunikim me Daniel Serwerin.

Analisti amerikan nëpërmjet "Twitter"-it e ka pyetur drejtpërdrejt presidentin Thaçi se a dëshiron të rinegociojë marrëveshjen

## Kërcënohet familja e presidentit Thaçi

**PRISHTINË, 12 GUSHT** - Një person nga fshati Jabllanicë e Klinës është arrestuar para dy ditësh me dyshimin se ka kërcënuar familjen e presidentit në fshatin Burojë të Skenderajt. Sipas burimeve të "Kallxo.com", banori i Jabllanicës ka shkruar në shtëpinë e familjes ku ka kërcënuar familjarët.

Arsyeja e kërcënimit, sipas burimeve, është pakënaqësia e qytetarit me ndarjen e një subvencionit në bujqësi. Lajmi është konfirmuar edhe nga prokurorja Fikrie Sylejmani, e cila është duke e hetuar rastin. "Vëllai i presidentit është ankuar për kërcënim", ka thënë prokurorja. Ajo ka shtuar se motivi i kërcënimit është pakënaqësia që personi i dyshuar e kishte rreth një granti. "Personi është arrestuar dhe unë kam kërkuar paraburgim për të", ka thënë prokurorja Sylejmani. Ajo ka thënë se për momentin nuk mund të japë më shumë detaje.

Avni Zaiti, zëdhënës i Policisë

në Mitrovicë, i ka thënë "Kallxo.com" se një person është ankuar në Stacionin Policor të Skenderajt për kërcënim. Sipas Zaitit, Policia ka arrestuar personin e dyshuar dhe është duke i zhvilluar hetimet.

Presidenti i vendit nuk ka në kompetencën e tij ndarjen e subvencioneve në bujqësi. "Kallxo.com" ka kontaktuar edhe me këshilltarin e presidentit, Artan Behrami, i cili ka premtuar që pasi të marrë informacione do të përgjigjet.



## Pas operacionit në ortopedi, pacientit i kthehen lëvizjet në këmbë

**PRISHTINË, 12 GUSHT (ER)** - Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në Klinikën e Ortopedisë është realizuar suksesshëm një operacioni i vështirë ku pacientit M. B., 52-vjeçar nga Mitrovica, i është kthyer lëvizja e këmbëve. Ai nuk mund të lëvizte këmbët për shkak të tumorit. Pas ekzaminimeve të nevojshme, ekipi i mjekëve nga

Klinikës e Ortopedisë ka vërtetuar se pacienti nuk mund të lëvizte si pasojë e një tumori në vertebra lumbale L2 dhe L1. Ekipi operator, pasi mori rezultatet diagnostike që i ishin kërkuar pacientit, vendosi që të njëjtin ta operonte. Pas pesë orëve të operacionit, pacientit i hiqet tumori dhe bëhet fiksimi i pasmë me vida dhe tashmë pacienti fillon të lëvizë këmbët.



Ministria e Integritimit Evropian dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kanë shënuar "Ditën Botërore të Rinisë"

# Të rinjtë: BE-ja t'ia hapë dyert Kosovës

Në "Ditën Botërore të Rinisë" të rinjtë e Kosovës kanë marrë mbështetje nga institucionet qendrore të vendit. Derisa disa prej ministrive kanë mbajtur aktivitete konkrete për ndër të kësaj dite, udhëheqësit institucionalë janë zotuar se do të krijojnë më shumë mundësi rreth punësimit të të rinjve. Në kuadër të Ditës Botërore të Rinisë, Ministria e Kulturës së bashku me dy organizata joqeveritare kanë organizuar një performancë artistike ku është kompletuar flamuri i BE-së me mesazhin që Kosova është gati për liberalizimin e vizave

**EPOKA  
ERE**

Arbisa SHEFKIU

**PRISHTINË, 12 GUSHT** - Me rastin e Ditës Botërore të Rinisë disa ministria kanë mbajtur aktivitete të ndryshme dhe u kanë premtuar të rinjve mbështetje qeveritare. Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, në prani të udhëheqësve rinorë të studentëve, OJQ-ve rinore, rinisë së partive politike, si dhe koordinatit nacional për rini, Avdullah

vizave. "Liberalizimi i vizave është i rëndësishëm për të gjithë qytetarët e vendit, më së shumti për të rinjtë tanë", ka thënë Hoxha. Sipas saj, Kosova ka rini të talentuar e të suksesshme dhe nuk ka nevojë të migrojë ilegalisht në vendet e BE-.

Ministrja Hoxha ka thënë se Qeveria është e përkushtuar për t'i adresuar sfidat me të cilat përballen sot rinia jonë. Ajo ka thënë se do të fokusohen në reformat në arsim, në mënyrë që të rinjtë tanë



Bashkimin Evropian, dhe jam shumë i bindur se ky aktivitet i sotëm koicidon edhe me kriteret dhe ato që shteti i Kosovës i ka

të jenë të lirë, të barabartë me të gjithë të rinjtë e Evropës", ka thënë ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi.

Ndërsa Arianit Jashari nga organizata "Access" ka treguar domethënien e instilacionit. "Organizata Access në bashkëpunim me Mollën e Kuqe kanë bërë instalacion në shesh që simbolizojnë gjashtë yjet e Kosovës, e që do të thotë në njëfarë forme se Kosova është gati dhe BE-ja duhet t'i hapë dyert për liberalizim që të rinjtë të lëvizim lirshëm", ka thënë Jashari.

Edhe presidenti i vendit, Hashim Thaçi, në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar për Ditën e Rinisë. "Dita Ndërkombëtare e Rinisë, 12 Gushti, sivjet na gjen në një pozitë më të mirë të të rinjve dhe me një përkushtim më të madh të tyre për njëri-tjetrin, përkundër që ende jemi larg asaj që ata kanë nevojë dhe ne duam. Tash jemi në prag të liberalizimit të vizave për qytetarët tanë dhe të rinjtë kosovarë së shpejti do të kenë mundësi të barabarta sikurse të gjithë të rinjtë e tjerë evropianë", ka shkruar presidenti.

Përmes mesazheve në rrjetet sociale, rinisë i ka dhënë mbështetje edhe kryeministri

Ramush Haradinaj dhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj. "Kosova është me fat që popullsinë e vet e ka të dominuar nga të rinjtë. Të rinjtë tanë sot më shumë se kurrë kanë mundësi të guxojnë, të kërkojnë dhe të ëndërrojnë. Ndonëse përballë kemi shumë sfida, Kosova është vend që ofron mundësi edhe për të rinjtë. Gjeneratat e reja që janë shumë në numër e shumë në ide, kanë krijuar modelin shembullor të të rinjve të arsimuar dhe energjikë, dhe që besojnë e promovojnë meritokraci dhe vlerë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe Limaj ka thënë se tash është koha që rinia të marrë përgjegjësi më të mëdha që Kosovën ta bëjë pjesë të Evropës. "Sot është ditë e veçantë për të gjithë të rinjtë. Kosova është me fat që ka një rini kaq të shëndoshë. Tani është koha që rinia të marrë përgjegjësi më të mëdha mbi vete që Kosovën ta bëjë pjesë të Evropës. Rinisë së Kosovës duhet ofruar hapësirën e nevojshme që me idetë, kreativitetin dhe energjinë pozitive që ka, të kontribuojë në shtetndërtimin e vendit. Gëzuar Dita Ndërkombëtare e Rinisë! Suksese!", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Hasani, ka mbajtur fjalë rasti duke theksuar se është një mundësi e mirë që të gjithë së bashku të mblidhemi rreth entuziazmit, kreativitetit dhe energjisë së të rinjve. "Në ditët e sotme, kur kemi ndryshime të shpejta në botë, zhvillim të teknologjisë dhe kur gjatë viteve të fundit mediat sociale kanë shkaktuar ndryshime të mëdha sociale dhe politike, forca e rinisë është më e rëndësishme se asnjëherë më parë", është shprehur ministrja Hoxha, duke shtuar se çdo ditë duhet të mendohejmë ta shohim botën përmes syve të të rinjve pasi, sipas saj, kjo është mënyra më e mirë për t'i ndihmuar të rinjtë dhe për t'u dhënë mundësi të jenë pjesë sa më aktive e shoqërisë. Ajo ka thënë se Kosova ka marrë rekomandimin pozitiv për përmbushjen e kriterëve të kërkuara për liberalizimin e

ta kanë mundësinë të jenë konkurrentë për tregun e punës në vend dhe jashtë.

**Ministri Gashi: BE-ja padrejtësisht po i lë të rinjtë tanë pa lëvizje të lirë**

Në kuadër të Ditës Botërore të Rinisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit së bashku me organizatat "Access" dhe "Molla e kuqe" kanë mbajtur një performancë artistike me moton "Kosova është gati". Me mbështetjen e MKRS-së këto dy organizata joqeveritare kanë organizuar instalacionin dhe performancën artistike ku është kompletuar flamuri i BE-së me mesazhin që Kosova është gati për liberalizimin e vizave. "Shteti i Kosovës, të rinjtë e Kosovës, duhet t'i kenë dyert e hapura për në

plotësuar kushtet për t'i pasur dyert hapur në Bashkimin Evropian. Besoj se ky vit të jetë viti kur të rinjtë e Republikës së Kosovës, që padrejtësisht kanë pasur probleme me lëvizjen e lirë,





# BQK-ja: Shkalla e rritjes ekonomike është luhatur rreth normës 3.5 për qind



Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka publikuar për herë të parë modelin makroekonomik për ekonominë e Kosovës. Sipas këtij modeli, rritja ekonomike reale ka qenë e qëndrueshme dhe është luhatur rreth normës 3.5 për qind. Rritja më e vogël u shënuar në vitin 2014 (rreth 1.2 për qind) si rezultat i vonësive në krijimin e institucioneve pas zgjedhjeve të qershorit 2014

**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 12 GUSHT** - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka publikuar për herë të parë modelin makroekonomik për ekonominë e Kosovës. Ky material studimor është përgatitur gjatë periudhës 2016-2017 nga Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar të Bankës Qendrore

të Republikës së Kosovës. Ndërkaq ka trajtuar një rezymë të rrjedhave ekonomike në vend për periudhën 2006-2015. Sipas këtij studimi, ekonomia e Kosovës është përbërur me sfidën e punësimit, rebalancit tregtar, procesin e privatizimit, ndërkaq është rimëkëmbur nga remitancat. "Ekonomia e Kosovës është një ekonomi e vogël e hapur, e cila që prej periudhës së pasluftës ('99)

është përbërur me sfida të shumta, ndër të cilat veçojmë: ndërtimin e kapaciteteve institucionale; formalizimin e ekonomisë; adresimin e shkallës së lartë të papunësisë; investimet në infrastrukturë; dhe procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore", është thënë në raportin e BQK-së, duke u shtuar se gjatë kësaj periudhe ekonomia e Kosovës ka shfaqur rritje ekonomike të qëndrueshme, e cila ka qenë e mbështetur kryesisht nga dërgesat e emigrantëve dhe donacionet e organizatave ndërkombëtare. "Periudha 2006-2015, gjatë së cilës modeli KMM është i vlerësuar, përfaqëson një periudhë të karakterizuar nga disa ngjarje të rëndësishme, si: shpallja e pavarësisë, kriza ndërkombëtare financiare dhe ngërçet politike, duke e përbërur ekonominë e Kosovës me sfida të ndryshme nga ato të periudhës së mëparshme",

thuhet në raportin e BQK-së. Sipas BQK-së, përkundër kësaj, rritja ekonomike reale ka qenë e qëndrueshme dhe është luhatur rreth normës 3.5 %. "Rritja më e vogël u shënuar në vitin 2014 (rreth 1.2 %) si rezultat i vonësive në krijimin e institucioneve pas zgjedhjeve të qershorit 2014. Kontributi kryesor negativ në rritjen ekonomike të vitit 2014 ka ardhur prej kategorisë së investimeve publike dhe konsumit publik. Gjatë periudhës 2006-2015 konsumi privat është komponenti që ka shënuar kontributin pozitiv më të madh në rritjen reale të BPV-së, mesatarisht rreth 2.9 pikë përqindje. Investimet private gjithashtu kanë shënuar kontribut pozitiv me përjashtim të vitit 2012, kur shënuan kontribut të ndjeshëm negativ me rreth 4.5 pikë përqindje, kryesisht si rezultat i rënies së ndjeshme të investimeve të huaja direkte dhe

ngadalësimit të kredive të reja për qëllime investimi. Kontributi i eksporteve neto ka qenë pozitiv vetëm në vitet 2012 dhe 2013, kur deficitin tregtar shënoi përmirësim për shkak të rënies së importeve dhe rritjes së eksporteve të shërbimeve. Megjithatë, gjatë gjithë periudhës së studimit deficitin tregtar i mallrave dhe shërbimeve, si përqindje e BPV-së, ka qenë i lartë duke u luhatur rreth vlerës 34 %. Ky raport i lartë i atribuohet bazës së ulët të eksporteve (veçanërisht ajo e mallrave) dhe varësisë së lartë të ekonomisë kosovare mbi mallrat e importuara. Ky deficit në bilancin tregtar, i cili ka shkaktuar edhe deficitin në llogarinë rrjedhëse të Bilancit të Pagesave në Kosovë, është reduktuar në masë të konsiderueshme nga flukset hyrëse të remitancave, transfertave zyrtare dhe investimeve të huaja direkte", është theksuar në raportin e BQK-së.



## Qytetarët arin e sigurojnë në shtëpi

PRISHTINË, 12 GUSHT - Qytetarët e Kosovës kanë sasi të ndryshme të metalit të çmuar, përfshirë edhe arin, por që këtë produkt vazhdojnë ta ruajnë në shtëpitë e tyre. Edhe pse bankat komerciale në Kosovë në bazë ligjore, përveç mjeteve financiare, ruajnë gjërat me vlerë, deri më tani asnjë person nuk ka marrë "guximin" që arin ta sigurojë në këto institucione. Njëra prej tyre është Blerina nga Prishtina. Ajo shprehet se nuk ka informacione se ekziston një mundësi e ruajtjes së këtij produkti në institucione. "Po, kam ari, jo në sasi të madhe. E mbaj në shtëpi. Nuk e di se ka mundësi ta ruaj në banka. E përdori herë pas here", ka thënë Blerina.

Por, Albana nga Mitrovica nuk beson se gjërat me vlerë t'i ruajnë në bankat komerciale. "Po, kam shumë ari, e kam blerë vetë, por edhe dhurata nga familjarët. Nuk u besoj bankave për ta ruajtur arin. Nuk e dërgoj asnjëherë", është shprehur Albana. Edhe zyrtarë të Bankës Qendrore të Kosovës tregojnë se deri më

tani asnjë nga këto rezerva nuk mbahen në këtë institucion.

Kushtrim Ahmeti, zëdhënës në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" "se ligji i lejon BQK-së që në kushte të veçanta, konform mundësive të saj hapësinore, t'u ofrojë palëve të kualifikuara ruajtjen e artikuljeve (gjësendeve) në trezorë për periudha të caktuara (që mund të jenë edhe në ari apo metale të çmuara). Tarifat për këtë shërbim thuhet se janë simbolike", ka thënë Ahmeti.

Ky vendim, sipas tij, merret vetëm me aprovimin dhe me përcaktimin e kushteve nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së.

Por, ekspertë për çështje financiare shprehen se kjo çështje është e lidhur me traditën e qytetarëve që gjësendet me vlerë, siç janë paratë dhe ari, t'i sigurojnë në shtëpitë e tyre. Megjithëkëtë, Nazmi Mustafa, rektor në Kolegjin e Menaxhmentit Internacional "Globus", ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë" se insti-



tucionet financiare ende nuk e kanë fituar besimin e qytetarëve që të marrin një veprim të tillë. "Një veprim i tillë ende nuk aplikohet aq sa duhet. Dhe, duhet shumë një besueshmëri ndaj BQK-së që, sipas mendimit tim, ende nuk ka ndodhur. Por, të

besojmë të gjithë se do të ndodhë kjo, do të fillojë një proces i tillë. Dhe, praktikisht, do të fitohet edhe një institucion i besueshëm në Kosovë ku njerëzit për gjërat e tilla që e kanë një vlerë edhe familjare edhe trashëgimtare, t'i ruajnë në

BQK", ka thënë Mustafa. Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës i jep të drejtën e mbajtjes së rezervave ndërkombëtare të arit apo metaleve të tjera të çmuara, por që momentalisht asnjërin nga këto rezerva BQK-ja nuk e mban.

## 'Trepça' e ndarë, asnjë komunikim me menaxhmetin në pjesën veriore



Prishtinë, 12 gusht - Gjiganti metalurgjik "Trepça", i ndarë në dy pjesë, në veriun e dominuar nga serbët dhe në jug me minatorë shqiptarë, edhe pas 19 vjet të përfundimit të luftës në Kosovë nuk është duke u rimëkëmbur. Ushtruesi i detyrës së menaxherit në këtë ndërmarrje, Miftar Hyseni, ka thënë se situata aktuale në

"Trepçë" nuk është e mirë pasi ka rënë të prodhimit. Hyseni ka theksuar se nuk pret që së shpejti të ndodhë ndonjë përmirësim. Ai në një intervistë për "Kosovapress" ka bërë me dije arsyet e kësaj gjendje në ndërmarrjen "Trepça", duke potencuar në rend të parë mungesën e fuqisë punëtore. Hyseni ka fajësuar të gjithë për situ-

atën e paqartë të krijuar në "Trepçë", duke thënë se duhet një qasje më serioze nga Qeveria, menaxhmenti, sindikata dhe të gjithë të punësuarit, në mënyrë që të zgjidhet problemi në mënyrë që në të ardhmen kjo ndërmarrje të zhvillohet. Sa i përket bashkëpunimit në mes të menaxhmentit të "Trepçës" nga

veriu dhe jugu, Hyseni ka thënë se deri vonë ka pasur kontakte, shkëmbim të pajisjeve dhe retro-materialeve, por jo ndonjë bashkëpunim konkret dhe të mirëfilltë. Hyseni ka bërë me dije se tani ky bashkëpunim është ndërprerë, sidomos prej formimit të bordit për "Trepçën". Ai ka theksuar se në këtë

situatë të re, e cila është krijuar kohët e fundit në ndërmarrje, veriorët kanë një qasje krejt ndryshe ngaqë instruksionet i marrin nga Beogradi. Më tutje, ai ka thënë se ndarja eventuale e vendit do të ishte në dëm të "Trepçës", derisa ka theksuar se rreth 20 për qind e rezervave gjeologjike minerare gjenden në veri të Kosovës.



## I riu nga Kamenica goditet me thikë, një muaj paraburgim ndaj tre të pandehurve

**KAMENICË, 12 GUSHT** - Gjykata Themelore në Gjilan ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore të Gjilanit, duke i caktuar masën e paraburgimit të pandehurve H. Sh., A. Sh. dhe B. A., në kohëzgjatje prej një muaji. I pandehuri H. Sh. dyshohet se

më 8. 8. 2018 rreth orës 22:50 minuta në lagjen "Çamëria" në Kamenicë me dashje ka tentuar të privojë nga jeta tani të dëmtuarin A. D., në atë mënyrë që gjatë rrahjes me një thikë e ka goditur në pjesën e qafës, në anën e majtë të gjoksit, duke i shkaktuar lëndime

të rënda trupore, ndërsa të pandehurit A. Sh. dhe B. A. me dashje kanë marrë pjesë aktive në rrahje duke e goditur të dëmtuarin në fjalë dhe të dëmtuarin tjetër. Gjyqtari i procedurës paraprake, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka vendosur

masën e paraburgimit për të pandehurit, pasi ekziston rreziku i ikjes ngaqë këta persona janë shqiptarë, me vendbanim në Republikën e Gjermanisë. Palët kanë të drejtën e ankesës ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Apelit.



## Përfundon fushata e korrje-shirjeve në Skenderaj

**SKENDERAJ, 12 GUSHT (ER)** - Në Komunën e Skenderajt ka përfunduar me sukses fushata e korrje-shirjeve me një sipërfaqe prej 6 300 hektarë sh grurë, 2 000 hektarë elb dhe 650 hektarë tërshërë. Sipas raportit të Komisionit për korrje-shirje, i përbërë nga pesë anëtarë, në procesin e korrjes së drithërave sivjet kanë qenë të angazhuara 110 autokombajna. Siç është thënë në këtë raport, përkundër disa problemeve të vogla, fushata e korrje-shirjeve është realizuar ashtu siç është hartuar dhe planifikuar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Skenderajt.

"Vlen të përmendet se çmimi për një hektar i rekomanduar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltari dhe Zhvillimit Rural të Kosovës (MBPZHR) është respektuar nga kombajnerët dhe ka qenë 100 euro për hektar. Në bazë të të dhënave nga terreni dhe analizave tona në terren, rendimenti mesatar në këtë vit ka qenë: grurë 3 500 kg për hektar, elb 2 000 kg për hektar dhe tërshërë 1 700 kg për hektar", është thënë në raportin e Komisionit komunal. Në këtë raport përmenden edhe faktorët që kanë ndikuar që fushata e korrje-shirjeve të përmbyllet suksesshëm, duke përfshirë edhe praninë e një



numri të madh të autokombajnave të Komunës së Skenderajt

të mbështetura edhe nga autokombajnat nga komunat e

tjera si dhe puna e komisionit në terren.

## Inspektorët e Komunës së Mitrovicës kërkojnë lirim dhe hapësirave publike

**Mitrovicë, 12 gusht (ER)** - Inspeksioni i Komunës së Mitrovicës ka vazhduar përpjekjet për të mbajtur rend duke detyruar shitësit t'i respektojnë rregulloret komunale sa i përket shitjes së produkteve. Ata kanë kërkuar nga shitësit lirim dhe hapësirave publike dhe trotuareve për lëvizje të lirë për qytetarë. Në ditët e fundjavës në orët e hershme të mëngjesit inspektorët komunalë Kimete Berisha dhe Shkumbin Osmani, të përkrahur

nga Policia e Kosovës, nuk i kanë lejuar shitësit që produktet e tyre t'i ekspozojnë në trotuare dhe hapësira të tjera publike, të parapara për shfrytëzim nga ana e qytetarëve. "Sot kemi dalë për të mos lejuar shitësit që produktet e tyre t'i ekspozojnë nëpër trotuare dhe hapësira të tjera publike për t'i shitur, pasi në këtë mënyrë po e pengojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve. Madje ky aksion është ndërmarrë edhe me kërkesën e qytetarëve, që trotuaret dhe



hapësirat publike të jenë të lira për lëvizje. Sot puna shkoi mirë dhe pa probleme. Ne do të vazhdojmë punën tonë me qëllim që produktet të shiten atje ku e kanë

vendin, në tregun e qytetit, ku ka vend për të gjithë", kanë thënë inspektorët Kimete Berisha dhe Shkumbin Osmani. Inspektorët komunalë njoftuan se

shitësit i kanë respektuar urdhëresat e inspektorëve dhe nuk ka pasur nevojë për intervenim të policisë apo shqiptim të ndëshkimeve mandatore.



## Aliu: Të rinjve ua besova qeverisjen në Ferizaj

**FERIZAJ, 12 GUSHT (ER)** - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka thënë se të rinjve ferizajas ua ka besuar qeverisjen. Ai në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë ka thënë se të rinjtë kanë ide dhe energji për t'i çuar përpara proceset zhvillimore. Aliu në llogarinë e vet në

"Facebook" ka shkruar se e vetmja rrugë për fuqizimin e rinisë është vendimmarrja nga ata. "Në kabinetin tim unë jam më i moshuari. Të rinjve në qeverisjen time i kam besuar përgjegjësi shtetërore. Jam i rrethuar nga ide, energji e dinamikë që vetëm të rinjtë

mund ta bartin në krahët e suksesit. E vetmja rrugë për fuqizimin e rinisë është vendimmarrja nga vetë ata. Këtë model e kam instaluar në çdo pore të jetës institucionale dhe do ta vazhdoj tutje. Urime 12 Gushti, Dita Ndërkombëtare e Rinisë!", ka shkruar Aliu.



# Kaosi dhe ikja nga përgjegjësia politike



**Blerim CANAJ**

Thënia e Otto Eduard Leopold Fürst von Bismarck, se "politika është arti i së mundshmes", duket të jetë e saktë. Këtë e vërteton fakti se neve si popull, si një "mi laborator", na ka prekur "e mundshmjia" dhe kemi ndjerë atë dhe për ne ajo më nuk është diçka e panjohur. Që në fundin e viteve 1980 dhe në fillimin e viteve 1990, kur edhe pjesa më pro jugosllave e intelektualëve shqiptarë në Kosovë, ata që besonin Jugosllavinë dhe në Jugosllavinë filluan të kuptojnë dhe pranojnë konceptin e ri nacional, madje edhe të bëhen pjesë e krijimit të koncepteve të reja nacionale, si tërësi shqiptarët janë ballafaquar me artin e së mundshmes. Por, gjithmonë me një të metë: Gjithmonë në përcjellje të kombeve të tjera, pas të gjitha kombeve të tjera dhe gjithmonë në defensivë. Madje edhe humbja e besimit në Jugosllavinë pati ndodhur vetëm kur u shfaqën hapur konceptet nacionale serbe të drejtuara kryesisht kundër shqiptarëve dhe kur patjetër duhej mbrojtja, për çka edhe filluan të promovohen konceptet nacionale shqiptare. Krejt kjo nga mungesa e guximit të ballafaqimit me të "mundshmen". Ballafaqimi me të mundshmen ka ndodhur vetëm kur shqiptarët janë mbështetur për muri pa rrugëdalje tjetër. Dhe atëherë kur ballafaqimi ishte domosdoshmëri, gjithmonë është krijuar një grup i caktuar i cili ka qëndruar mënjanë duke i ikur përgjegjësisë politike me dëshirën që ai që kishte marrë guximin e ballafaqimit të humbë në këtë ballafaqim. Humbjes së ballafaqimit madje i ndihmojnë duke kritikuar ballafaquesin dhe duke e shpallur apriori tradhtarë. Pra, ne nuk jemi mësuar të kemi kritikë të përcjellë me ide, por gjithmonë një kritikë e përcjellë me shumë ofendim. Tekefundit, inatet politike në mes të shqiptarëve nuk janë diçka e re që kanë lindur në kohën tonë, prandaj kjo edhe nuk do duhej të jetë brengë, por brenga mbetet tek të mosmësuarit nga sprova. Krijimi i rivaliteteve politike në

çështjet vendimtare ka bërë që shqiptarët kurrë të mos mund të punojnë në grup, të mos mund të shkëmbejnë idetë. Duke vendosur në rend të parë politikën grupore të aktorëve partiakë dhe duke mos menduar në një interes më të gjerë, mungesa e dijes së koordinimit dhe funksionimit si grup ka qenë - dhe si duket edhe më tutje mbetet - një nga mangësitë e mëdha. Dëshira për ta marrë epitetin e të parit, pa pasur parasysh aftësitë negociuese, ka çuar edhe në verbërim të aktorëve të caktuar duke ndikuar shumë në masën në drejtim të mospërkrahjes së liderëve negociues dhe me këtë duke shtyrë kështu dobësimin e tyre në tavolinat negociuese e kështu duke ndihmuar Serbinë që ajo në skenën ndërkombëtare të paraqitet si viktimë e jo si agresor. E nëse shikohet ecuria në dhjetë vjetët e fundit, mund të thuhet lirshëm se politikanët serbë këtë e kanë bërë për mrekulli. Sot ajo ka arritur që përkundër faktit të vrasjeve masive, të paraqitet dhe nga shumë shtete edhe të shihet si viktimë duke harruar epitetin e agresorit.

Edhe sot, që nga hedhja e idesë së korrigjimit të kufijve me Serbinë, vërehet e njëjta gjë. Mjafton një sy në rrjetet sociale, ku politikbërësit janë mjaft aktivë dhe vëren kaosin e ideve, mendimeve dhe shprehjeve denigruese që lart nga pretendentët e froneve e deri poshtë te qytetari përkrahës. Madje në stilin "për inat të nuses e mbys djalin" direkt apo indirekt vërehen tendencat e mbledhjes së poenëve politikë, por jo ndjenja e përkrahjes për zgjidhjen më të mirë dhe forcimin në tavolinën negociuese. Është e qartë se udhëheqësi gjithmonë ka për obligim që vendin ta drejtojë në fitore, por sukcesi i udhëheqësit gjithmonë varet nga përkrahja që ka. Tani nuk e kam fjalën për përkrahjen nga votuesi, por nga spektri politik, duke i futur këtu edhe pjesëtarët e shoqërisë civile, madje edhe pseudoanalistët e politikës. Kur flas për përkrahjen, mendoj në përkrahje me ide, por jo duke shkaktuar kaos politik. Ikja nga përgjegjësia politike e secilit individ në këtë rast rezulton me konsekuencë që do të bartim jo vetëm ne, por tërë gjeneratat pas nesh. Tekefundit, kjo na ka ndodhur edhe gjatë luftës: Sot jemi viktimë të ndarjes së taborëve, të mosballafaqimit, madje edhe mohimit të realitetit qysh në atë periudhë.

Shtet kemi po aq sa kemi luftuar për të, as më shumë dhe as më pak. Shtetin e mbajmë po aq sa unifikohemi në identifikimin me të dhe luftojmë për të. Në momentin kur popullata e shtetit nuk identifikohet me shtetin, shteti është i paraprirë për shkatërrim, thotë historiani gjerman Holm Sundhausen në librin e tij "Jugosllavia dhe shtetet pasardhëse të saj". E identifikimin me shtetin e promovojmë varësisht nga ajo se sa jemi të gatshëm të marrim përgjegjësi politike nga i tërë spektri politik. E pyetjet që në Kosovë ende kërkojnë përgjigje janë: Sa ka ndihmuar spektri politik - gjithnjë duke aluduar në tërë spektrin - në identifikimin e popullatës me shtetin? Sa kemi mundur të krijojmë një mit politik shtetëror? Përmendja e mitit politik, mund të duket e tepruar, por nëse shikojmë ndërtimin e të gjitha shteteve, atëherë vëre-

jmë që shumica e tyre - në mos jo të gjitha - zhvillojnë ideologjitë shtetërore pikërisht mbi bazën e këtyre miteve politike. E në Kosovë, për hir të poenëve politikë kemi shkatërruar dhe denigruar figurat që do të mund të ishin mitike, madje bazë e mitit politik që nga periudha e politikës paqësore e fundit të shekullit të kaluar e deri tek udhëheqësit e luftës. Mjafton të pyesim një tinxher kosovar se sa ai di për luftën e fundit në Kosovë dhe ne e vërejmë këtë si më së miri. Të mos flasim për shqiptarët në Shqipëri, sepse pastaj do të jetë tejet e çuditshme dhe dëshpëruese kur një intelektual/e gati në të 40-tat e tij/saj të flet për atë se si në Shqipëri nuk kishin ide për Kosovën.

Aktualisht ballafaqohemi me idenë e korrigjimit të kufijve dhe disa aktorë politikë bëhen sikur janë të befashuar nga kjo ide si pjesë negociuese. E, në

fakt, këtu nuk ka asgjë për t'u befashuar sepse thjesht negociatat gjithmonë janë rrjedhë që duhet të ndodhin pas luftërave dhe me të cilat provohet të mbyllen çështjet që nuk kemi mundur t'i mbyllim në luftë. Përparësia është që kemi një "ballafaques" me përvojë që nga promovimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës duke fituar përkrahjen ndërkombëtare në rolin e udhëheqësit politik, pastaj si kryenegociator në Rambuje u bind Bota për nënshkrimin e Serbisë, por edhe si shef Qeverie Kosova pas shumë vitesh shpalli pavarësinë. A ishin rastësi këto dhe rastësi pas rastësie shumë "rastësi" të tjera?! Unë nuk besoj në rastësi.

*(Autori është pjesë e diplomacisë së Kosovës. Pikëpamjet në këtë tekst janë vetëm të tij)*



## Në Shenjtëroren e Letnicës kujtohet Nënë Tereza


**PRISHTINË, 12 GUSHT** - Më 14 gusht do të festohet 90-vjetori i shkuarjes së Gonxhe Bojaxhiut - Nënë Terezës në Kalkuta. Për ta shënuar

këtë jubile të rëndësishëm të jetës së Nënë Terezës, Kisha Katolike në Kosovë, e prirë nga Ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë

Gjergji, organizon shtegtimin e Dritës së Qiriut të saj nga Katedralja Shën "Nënë Tereza" në Shenjtëroren e Letnicës.



# Tri enigmat e mëdha të Vettingut



**Bedri ISLAMI**

Procesi i Vettingut mbi sistemin e drejtësisë është tashmë në ditët e tij të pushimit, pasi ka lënë pas vetes "kufoma" të prokurorëve dhe gjyqtarëve, thuajse gjysmën të cilët nuk e kaluan dot atë. Ishte një provim i vështirë, i pamenduar më parë dhe që, si ka qenë e ditur, i domosdoshëm.

Jorastësisht, pothuajse të gjithë krerët e sistemit, që nga ai i Gjykatës Kushtetuese, ndaj të cilit ONM po bën kundërshtimin e saj, Prokurori i Përgjithshëm dhe ndihmësit e tij të shkallës së lartë, të cilët dolën jo edhe aq befasisht fundistë dhe sekserë shitblerësh apo pronarë të zhytur në të zezë, kryetari i Gjykatës së Lartë, ndaj të cilit është e njëjta strukturë që vëzhgon, por që, si duket, më shumë do të jetë objekt i një propozimi të shefit të dikurshëm të Qeverisë sesa motivimi i profesionit, e deri më tej, tek ata që synuan të jenë pjesë vendosëse e sistemit të ri, ka pasur largime, të cilat e kanë bërë sot të jetë jashtë sistemit dy nga hallkat më të rëndësishme;

Gjykata Kushtetuese dhe ajo e Lartë. Vettingu, i cili po merrej si një shaka e radhës, më në fund po jep

shpresën se kësaj here, në mos vendësit, të paktën ndërkombëtarët e kanë seriozisht dhe se janë lodhur e ngopur deri në fytyrë me bëmat e pashoqe të drejtësisë shqiptare.

Megjithatë, tri enigma të mëdha janë të vendosura para saj, të cilat ose do të zgjidhen duke i dhënë rrugë përfundimisht pastrimit të sistemit dhe bërjes së drejtësisë në drejtësi, ose do t'i lërë gjërat në mesin e rrugës dhe nuk do të jetë e zbatueshme ajo fjala e vjetër, "fillimi i mbarë, gjysma e punës". Sepse gjërat mund të përmbysen. Enigma e parë: Si është lejuar që në sistemin tonë të drejtësisë të kenë bërë ligjin, të jenë promovuar, rritur në detyrë dhe bërë koka e tij pikërisht figura të tilla, thellësisht të korruptuara. Në vendin tonë ka pasur dhe vazhdon të ketë një Këshill të Lartë të Drejtësisë, mbi të cilin ka qenë dhe është presidenti i vendit. Ka pasur dhe vazhdon të ketë një institucion i cili merret posaçërisht me kontrollin e verifikimin e pasurisë. Megjithatë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, më shumë në vitet e fundit, ka bërë emërime të çuditshme, ka qenë jo ajo që është pritur, një Këshill organizativ, vendimmarrës dhe ndëshkues, por këshilli i qokave, përkëdheljeve dhe kundërshtive ndaj qeverisë, duke e parë këtë të fundit jo si strukturë e drejtimit të shtetit, por armike të saj.

Në Këshillin e Lartë të Drejtësisë u vendos një rrymë politike, që fare mirë mund të quhet gjingjonizëm,

me frymëzim nga endësia e plepave, për një drejtësi të kapur fund e majë, shërbyese ndaj pushtetit deri në themel dhe që përmes besnikërisë së saj ka qenë jashtë kontrollit të vet shtetit, pra jashtë kontrollit të parlamentit dhe të sistemit.

Disa nga anëtarët e këtij Këshilli janë që tani jashtë sistemit, shumë prej tyre thjeshtë nga pasuria e pambuluar, të tjerë do të jenë po ashtu jashtë sistemit, sepse, si shokët e tyre, nuk mund të justifikojnë as pasurinë e deklaruar.

Në Shqipëri, sidomos pas vitit 1992, drejtësia është bërë shpata e pushtetit mbi vetë sistemin. Dua të risjell një shembull të përjetuar nga takimi i ish Presidentit Berisha, sapo ishte zgjedhur në atë post, me demokratët e Shkodrës, në teatrin "Migjeni". Ndërsa ai po fliste për ndryshimet që do të ndodhnin, një ish i burgosur politik, Dedë Kasneci, pyeti gjithë mllef, përse qeveria dhe presidenca kishin vënë në drejtimin e njërës prej Gjykatave më të rëndësishme, një ish gjyqtar të komunizmit, i cili kishte bërë në atë qytet gjyqin e fundit politik, ku kishte dhënë dy dënime me vdekje, ish ushtarakët Rustem Tabaku dhe Enver Bicakani. Ish-presidenti u përgjigj se njeriu i kishte ndihmuar në hartimin e statutit të partisë, të proceseve të tjera, pra u kishte shërbyer dhe shtoi, "Kë të bëjmë, më jep, ti Dedë, disa emra dhe unë po i emëroj gjykatës".

Ky ishte mentaliteti i demokratikasve që erdhën në

pushtet; sipas shërbimit dhe nga baza. Deda ishte njeri i mirë, por nuk merrte vesh nga drejtësia, ose, në rastin më të mirë, dinte vetëm aq sa ishte marrë drejtësia me të.

A do të ketë pasoja për njerëzit që i emëruan, që i morën në mbrojtje këto gjykatës e prokurorë të korruptuar apo gjithçka do të shkojë me një mbyllje të lumtur?

Proces verbalet e mbledhjeve në Këshillin e Lartë të Drejtësisë janë ende aty. Aty mund të shihet edhe sot se kush mbrojtje dhe cilin, përse ishte kjo mbrojtje edhe kur gjërat ishin krejt të hapura, cilat lidhje kishin funksionuar etj.

Nëse nuk bëhet kjo, gjërat, pas disa vitesh, kur ndërkombëtarët të mos jenë më, do të përsëriten. Çdo faj që nuk ndëshkohet, ai përsëritet.

Enigma e dytë: Shumica e atyre që po largohen nga procesi i Vettingut është për pasurinë e deklaruar të tyre. Po ajo, e padeklaruara?

Pasuria është njëra nga tre kontestimet në profesion.

Çfarë ka ndodhur me dy të tjerat? A mos vallë janë ato më pak të rëndësishme se vjedhjet që kanë bërë, mashtrimet, përfitimet?

Nuk do të jetë harruar, për shembull, gjyqi i "famshëm" ndaj një trafikanti turk, i kërkuar nga drejtësia e shtetit gjerman, i cili u la të shkonte në arrest shtëpiak dhe shtëpia e tij ishte "Tek kthesa e Kamzës".

Natyrisht trafikanti ia mbathi. Gjyqtari që mori vendimin, duke gjetur sebepe juridike të paditura,

nuk mbajti asnjë përgjegjësi. Ka njeri që mendon se ai ose ajo e bëri këtë se deshi të ishte më i saktë se drejtësia e shtetit gjerman? Ka njeri që nuk e di se adresa "tek kthesa e Kamzës" do të thotë në askund?

Sa gjyqe të tilla ka pasur: me qindra. Njerëz të dërguar në gjykim për vrasje që janë lënë të lirë dhe kanë vlarë përsëri. Njerëz të politikës që, pasi kanë bërë tenderë hajdutësh të mëdhenj, janë lënë të lirë për procedurë. Vrasës në mesin e Bulevardit, për të cilët besohej një ekspertizë e detyruar se plumbat kanë bërë rikoshetë, edhe pse para tyre nuk kishte asnjë pemë?

Nëse do të kenë largime thjesht për pasuri të pajustificuar, mbajeni mend, shumë prej tyre do të kthehen, pasi në shkallën tjetër ato do të jenë më të përgatitur për të mashtruar dhe se, rruga tjetër, Gjykata e Strasburgut, nuk do të jetë kaq e ashpër, sepse nuk i shkon në mendje se gjyqtarët e prokurorët tek ne janë nga fisi i peshkaqenëve të mëdhenj.

Enigma e tretë: Çfarë do të bëhet me ato që po largohen nga sistemi i drejtësisë?

Do i mbajnë pronat që i vunë përmes vjedhjes dhe korruptimit? Do të shkojnë rehat në shtëpitë e tyre dhe me kaq mbaroi gjithçka?

Një Vetting që vetëm largon, pa u shoqëruar me një "Vetting" që ndëshkon është vetëm gjysma e rrugës.

Askush nuk dëshiron të mbesë në gjysmën e rrugës, vetëm me përjashtim të atyre që na e bënë rrugën e drejtësisë një rrugë ferri.





## 'Dokufest'-i, institucion i veçantë i kulturës

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se Festivali "Dokufest" është një ngjarje e cila e ka bërë të njohur Prizrenin dhe Kosovën gjithandej botës, veçanërisht tek artistët dhe tek industria e filmit



Kosovën në mënyrën më të mirë të mundshme në gjithë botën, e një prej tyre është edhe ngjarja më e madhe kulturore, siç është Festivali 'Dokufest', të cilin me plot të drejtë mund ta quajmë jo vetëm festival, por edhe një institucion i veçantë i kulturës në Kosovë", ka thënë

ministri Gashi. Ai ka bërë me dije se kanë rritur buxhetin e Qendrës Kinematografike të Kosovës. "Duke i pasur parasysh rezultatet e këtij festivali, por edhe të filmave tanë gjithandej botës, para dy-tre ditësh kemi marrë vendim që buxhetin e

Qendrës Kinematografike të Kosovës, i cili ka qenë diku rreth 750 mijë euro, ta rrisim për 100 për qind, me qëllimin e vetëm që gjithë njerëzit që e punojnë filmin të kenë mbështetjen e duhur të shtetit", ka thënë Gashi. Ndërsa drejtori artistik i "Dokufest"-it, Veton Nurkollari, ka falënderuar ministrin Gashi për kujdesin që po tregon për Qendrën Kinematografike të Kosovës. "Dua ta shfrytëzoj këtë rast dhe ta falënderoj ministrin për lajmin e jashtëzakonshëm, për dyfishimin e buxhetit të Qendrës Kinematografike të Kosovës, që në përkthim do të thotë më shumë filma nga Kosova për Kosovën, më shumë njohje ndërkombëtarisht me anë të filmit dhe unë shpresoj që ai dyfishim të trefishohet, katërfishohet dhe të kemi sa më shumë suksese", ka thënë Nurkollari.

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka organizuar pritje për pjesëmarrësit e Festivalit "Dokufest". Gjatë këtij organizimi ministri Gashi ka thënë se Festivali Ndërkombëtar i Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër "Dokufest" është ngjarja më e rëndësishme kulturore jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë. "Përgjatë ditëve sa mbahet festivali, qyteti i Prizrenit vërshohet nga mijëra vizitorë nga shumë vende të botës. Filmata shfaqen në disa kinema, duke përfshirë edhe kinematë nën qiellin e hapur. Ky festival është

një ngjarje e cila e ka bërë të njohur Prizrenin dhe Kosovën gjithandej botës, veçanërisht tek artistët dhe tek industria e filmit", ka thënë ministri Gashi. Ai ka shtuar se Ministria e Kulturës ka mbështetur fuqishëm organizimin e festivalit të sivjetshëm e cila si ngjarje kulturore po e promovon Kosovën gjithandej, duke sjellë shumë filma e artistë në Prizrenin e bukur. "Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke pasur gjithmonë parasysh rezultatet e mëdha të artistëve, krijuesve dhe performuesve tanë, e veçanërisht njerëzve të filmit, të cilët po e promovojnë

## Hapet ekspozita fotografike 'Unë jam shqiptar'



PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Në kuadër të kalendarit të përbashkët kulturor ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë, Muzeu i Kosovës në bashkëpunim me Muzeun Historik Kombëtar ka hapur ekspozitën fotografike "Unë jam shqiptar". Ekspozita e cila për tematikë ka emigrimin e shqiptarëve përfshin materiale fotografike mbi diasporën shqiptare ndër shekuj. Ekspozita fillon në mënyrë kro-

nologjike me fotografinë e heroit kombëtar Gjergj Kastriotit Skënderbeut, si përfaqësues i epokës më të lavdishme të shqiptarëve, por dhe kohës kur filluan valët e para të emigrimit shqiptar. Ekspozita përmban fotografi të arbëreshëve të parë me ngulimet e tyre në Italinë e Jugut, fotografi të arvanitasve dhe rilindësve shqiptarë. Fotoja e emigrantit të parë në ShBA është moment i rëndësishëm në ekspozitë, duke vijuar me fotografi të shoqërive të para patriotike në Sofje, Bukuresht,

Kajro, Stamboll e Vjenë. Pjesa tjetër e ekspozitës, por jo më pak e rëndësishme, prezantohet nëpërmjet fotografive nga personalitetet e suksesshme shqiptarë në vendet e emigrimit të tyre. Në hapje të ekspozitës ka marrë pjesë edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, i cili e ka vlerësuar ekspozitën si një sjellje para nesh të një kujtese të vuajtjes dhe historisë së dhimbshme që ka përjetuar populli shqiptar nëpër periudha të ndryshme të historisë.

## Kalendari kulturor Shqipëri - Kosovë po i jep dinamikë të re shkëmbimit kulturor

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Ministri i Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë, Blendi Klosi, ka thënë se kalendari i përbashkët kulturor në mes të ministrive përkatëse të kulturës i ka dhënë një dinamikë të re shkëmbimit kulturor në mes të Shqipërisë dhe Kosovës. Ai ka bërë me dije se një zhvillim shumë inkurajues është edhe bashkëpunimi në mes të medieve dhe shkëmbimi i produktit mediatik mbi promovimin e turizmit shqiptar. Klosi ka thënë se kohët e fundit ka rritje të numrit të fotografëve dhe blogerëve shumë të suksesshëm nga Kosova, të cilët

zbulojnë bukuritë e peizazhit natyror dhe kulturor të Shqipërisë dhe bëjnë një promovim shumë efektiv për publikun e Kosovës dhe më gjerë. "Ne tanimë po përgatitemi për një organizim të madh në Prishtinë ku do t'i konkretizojmë planet për rritjen e bashkëpunimit turistik në mes të Shqipërisë dhe Kosovës, duke i bërë bashkë operatorët, gazetarët, artistët, profesionistët dhe zyrtarët e institucioneve publike qendrore dhe lokale. Deri në fund të këtij viti ne do të kemi një dokument të ri strategjik mbi promovimin e turizmit shqiptar,



diçka që i ka munguar turizmit tonë deri tani. Synimi ynë është

të jemi sa më të fokusuar, efektivë dhe të mençur për shpenz-

imin e parasë publike për promovimin turistik të vendit tonë. Pjesë e kësaj qasje të re strategjike për promovimin turistik do të jetë edhe Kosova, natyrisht, mbi të gjitha promovimi i Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe rajonit të Ballkanit Perëndimor, si destinacion i përbashkët në tregje të treta. Ne besojmë se bashkëpunimi rajonal turistik, në këtë pikë ai me Kosovën, është më kryesor për ne, dhe do të na mundësojë të jemi sa më të konkurrueshëm në një treg global turistik gjithnjë në rritje", ka thënë ministri Klosi.



# ADEM DEMAÇI ,I DËRGUARI I ZOTIT PËR SHPËTIMIN E KOSOVËS...'

(Shënim përkujtimor për vëllanë, Adem Demaçin)

ESSAT H. BILALI

Me të dëgjuar lajmin e zi të vdekjes së Adem Demaçit (29 korrik 2018), nismëtarit të luftës për liri dhe bashkim kombëtar në Kosovë, trupi m'u rrëqeth dhe lotët më shpërthyen. Kjo ndodhi jo vetëm pse ai ishte frymëzuesi im i qëndresës kombëtare që nga bankat e gjimnazit (Prizren, 1952-1960), por edhe pse ishte vëlla imi, siç i thoshim njëri-tjetrit dhe bashkëluftëtarë pastaj në betejat e mëdha për liri e bashkim kombëtar ("Forumi" dhe Amerika). Si gjimnazistë që ishim gjatë fillimit të veprimtarisë së tij, thirrjen e Adem Demaçit për liri dhe bashkim kombëtar e dëgjuam me pandehje, kur Jugosllavia me moton raciste të "vëllazërim bashkimit" ishte "parajsë" e Botës (1960) së "qytetëruar", por ferr i shqiptarëve të "paqytetëruar". Zërin kryengritës të Adem Demaçit atëherë e dëgjoim me pandehje shumëkush në atë ferr dantesk, madje duke ua përzier ndjenjat që shtypeshin me përdhunë nga armiku i dyfishtë: ideologjia komuniste dhe shovinizmi pansllavist, por pakkush e përkrahu atë haptas, sepse ai dukej i pashpresë, anakronik nga rrenat shoviniste dhe shumë i rrezikshëm. Por, për Adem Demaçin largpamës, trim i pashoq dhe idealist i madh, ai zë ishte rëndomësi e domosdoshme.

Si i këtitillë, mund të thuhet se Adem Demaçi ishte i dërguari i Zotit që jo vetëm të përpiqet, por edhe të bëjë diçka kundër të keqes së popullit të tij, një barrë shumë e rëndë, më e rëndë se guri i Sizifit. Se kjo qëndron, sikur e tregon rebelimi i tij kundër salltanateve fashiste në flamurin kombëtar shqiptar në klasën e mësimi që në moshën e mitur. Shpirtin prej kryengritësi kundër pushtuesit tjetër të vendit të vet pastaj Adem Demaçi e kaliti dhe e shprehu si dallojë të shpirtit të tij gjatë gjithë jetës, madje në çaste jo vetëm të brishta, por edhe të rrezikshme. Duke vazhduar kështu, që në moshë të re, me një gjuhë vendëse, të thjeshtë dhe fort të qartë të një të riu, vazhdoi ta ngrejë zërin fuqishëm kundër të keqes edhe në rang letrar me veprën monumentale të atdhetarizmit shqiptar "Gjarpijt e gjakut" ("Jeta e re") - kushtrim i fuqishëm për bashkimin e popullit shqiptar në luftën e madhe kundër gjarpinjve të gjakut. Në atë mes ferrit dantesk që quhej



Jugosllavi, Adem Demaçi, një njeri me trup të vogël, me largpamje të madhe dhe me guxim të veçantë, do të shkojë edhe më tej me mendimin edhe më të rrezikshëm, duke kërkuar me zë e zhurmë bashkimin e kombit shqiptar, që vuante nën çizmen gjakatare të dyfishtë: shoviniste dhe komuniste serbo-jugosllave nën moton raciste të "vëllazërim bashkimit". Si rëndom, qeveria pushtuese serbo-jugosllave përpiqej t'i bëjë për vete kundërshtarët e saj. Këtë ide korruptive ajo u përpoq ta përdorë edhe ndaj Adem Demaçit, duke i premtuar atij të gjitha të mirat, madje për ta futur edhe në partinë gjakatare komuniste me "kart blank" për të bërë gjithçka, pa i dhënë përgjigje askujt. Por ato manovrimet të pista të armikut të Adem Demaçit nuk gjetën përkrahje. Shpirtin e qëndresës së Adem Demaçit nuk kishte forcë që e thyente. Prandaj atë do ta burgosin për ta shkatërruar, duke e izoluar dhe duke e thyer shpirtërisht. Por, ndonëse Adem Demaçi u burgos dhe u mbajt në burg për 28 vjet, më shumë se çdo disident në botë, shpirti idealist shqiptar i tij nuk u the. Përkundrazi, ai u feshitizua në mendjen e popullit, duke e apoteozuar atë si simbol i lëvizjes për vazhdimin e

qëndresës. Gjatë kohës që ishte në burg, zëri i tij ushtonte në përkrahje të luftës për liri dhe të drejta njerëzore dhe kombëtare. Po ashtu, edhe kur doli nga burgu më 1990, pas 28 vjetësh nëpër ferret e Udbës gjakatare..., ai nuk kishte ndryshuar, por me guxim të pashoq tha: "Dola nga burgu i vogël dhe hyra në burgun e madh" dhe vazhdoi misionin pa luhate me një numër veprimtarish, duke përhapur zërin e lirisë dhe të bashkimit kombëtar...

Si i këtitillë, edhe lufta në Kosovë nuk i lëkundti bindjet e tij. Edhe në atë tmerr, kur disa ikin ose e ndërronin identitetin për të shpëtuar, Adem Demaçi jo vetëm qëndroi në epiqendrën e luftës, në Prishtinë, por mori pjesë vepruese, duke qenë përfaqësues i UÇK-së e pastaj edhe duke ecur në ballë të demonstratave e me parulla kundër pushtuesit... Adem Demaçi nuk zbrapseej, sepse ishte nga ata guximtarë të vendosur, që luftonte me moton "ja vdekje ja liri"! Për këtë, ai jo vetëm u përzemërsua me krahun luftarak për liri, duke hapur zyrën e UÇK-së në Prishtinë edhe në atë gjendje, por edhe u bë pjesë e saj, madje duke pasur guximin të bëhet drejtues i saj. Me këto virtyte ai vazhdoi ta luajë rolin e simbolit të qën-

dresës jo vetëm për fillimin e saj, por edhe për zhvillimin dhe vazhdimin e luftës për liri dhe të drejta gjer në fitore.

Për këtë, nëse lufta heroike e popullit shqiptar për 25 vjet me radhë prirë nga Gjergj Kastrioti kundër pushtuesit shekullor turk u bë kushtrim i luftës së ardhshme të shqiptarëve për liri gjatë shekujve, ashtu siç u bë edhe shpirti i Lidhjes së Prizrenit kushtrim për ta vazhduar luftën për liri më tej, mund të thuhet se edhe zëri i Adem Demaçit për liri dhe bashkim kombëtar u bë kushtrim i luftës së popullit shqiptar për liri gjatë afër një shekulli.

Ajo që, pos të tjerash, është një mrekulli e shpirtit të Adem Demaçit, është se të gjitha këto dënime ai nuk i priti as me shqetësim të shpirtit, as me lot të syve, po me buzëqeshjen e tij të ëmbël dhe të habitshme, sigurisht se ironike me plot e përplot mllef për armikun!

Megjithatë Adem Demaçi ishte idealist i madh, idealet e tij nuk ishin dogma të ngurta. Si shumica e atdhetarëve të Kosovës, edhe Adem Demaçi e konsideronte Shqipërinë mëmëdhe nënë dhe udhëheqjen e saj komuniste idol, gjithashtu edhe për inat të Titos që të vriste duke u zgërdhirë. Por kur doli nga burgu dhe mësoi se ata ishin diktatorë që i kishin duart

e përlyera me gjak të njerëzve të pafajshëm, e zhduku librin që e kishte shkruar më parë me lëvdata imagjinare për ta...

Se sa e shenjtë ka qenë përpjekja e Adem Demaçit për liri jo vetëm për popullin shqiptar, por edhe për gjithë njerëzimin, e tregon fakti se atë jo vetëm e dëgjoim bota e qytetëruar, por edhe i dha një numër njohjesh. Megjithatë, këtë shpirt të madh njerëzor disa nuk ia njohin popullit shqiptar, por shtypësit të tij, pra duke e falsifikuar të vërtetën. Kjo jo vetëm është e habitshme, por edhe të lë me gisht në gojë!

Edhe në çastin e fundit në shtratin e vdekjes Adem Demaçi i kujtoi shqiptarët duke kërkuar të bëhen të mirë, sipas fjalës së vajzës së tij, Abetares, që mbajti në varrimin e tij. Ajo tregon që mirëqenia e shqiptarit për Adem Demaçin ka qenë obsesion i jetës së tij. Por edhe ashtu siç janë ata, ka mjaft shqiptarë të ndjeshëm, atdhetarë të përkushtuar dhe idealistë të çiliterë, të cilët, o Adem Demaçi, do ta kujtojnë Adem Demaçin për ndezjen e zjarrit të lirisë, për nxitjen e bashkimit kombëtar dhe për angazhimin e tij në luftën titanike për çlirimin e Kosovës.



## Shakira, një 'uragan' i vërtetë



**S**hakira ka performuar në "Madison Square Gardens" (Nju Jork) si pjesë e turneut të saj veror. 41-vjeçarja ka ngritur në këmbë publikun me energjinë që përcolli gjatë performancës.

Këngëtarja ishte fenomenale, duke dhuruar një shfaqje të mrekullueshme dhe të paharrueshme. Bukuroshja kolumbiane ishte veshur me streçe rrjetë, ku ekspozonte këmbët e tonifikuara.

## Jennifer Lopez, shëtitje me të dashurin në Itali



Jennifer Lopez ndodhet në Itali, ku po shijon pushimet me të dashurin Alex Rodriguez. Sigurisht se sytë ishin të gjithë te këngëtarja e famshme e cila po bënte një shëtitje me varkë me të dashurin. 49-vjeçarja

dukej e mrekullueshme, veshur me një bluzë të bardhë dhe pantallona rozë të lehtë. J-Lo dhe 43-vjeçari Alex prej një viti e gjysmë janë në krahët e njëri-tjetrit dhe duket se gjërat mes tyre po shkojnë mjaft mirë.



## Rita Ora, energjike dhe plot sharmë në skenën e 'Ascot'

**R**ita Ora njihet për vokalin e mrekullueshëm dhe praninë në skenë. 27-vjeçarja u shfaq mahnitëse dhe mjaft e veçantë në skenën e Ascot Racecourse (Angli).

E veshur e gjitha në blu, Rita Ora elektrizoi skenën me performancë. Plot sharmë dhe e kompletuar në çdo detaj, 27-vjeçarja tregoi edhe një herë se skena është bërë për të.

## Denzel Washington kërcënon këdo që i ngacmon vajzën



**D**enzel Washington ka treguar anën e tij atërore, si një baba tipik. Ai kërcënoi se "do t'i thejë kokat" kujt do të ngatërohet me vajzën e tij në industrinë kinematografike me aktoren Olivia. Fituesi i dy çmimeve "Oscar" ka pohuar se industria ka ndryshuar së

tepërmi që pas skandaleve të ngacmimeve seksuale. Olivia, 27 vjeçe, është shfaqur në vitin 2013 në filmin "The Butler", ku luajti përkrash Forest Whitaker dhe Oprah Winfrey. Ajo ka interpretuar edhe rolin e një agjenteje të FBI-së në serinë televiziv "Mr Robot".



# Shuhet nobelisti VS Naipaul, shkrimtari i melankolisë së gjatë

V S Naipaul një nga emrat e njohur të letërsisë botërore librat e së cilit erdhën në gjuhën shqipe nga “Shtëpia Botuese Saras” është shuar në moshën 85 vjeçare. “Qyteti bri lumit” përkthyer nga Lavdimir Marku dhe “Shkrimtari dhe bota” përkthyer nga Blendi Lami janë dy libra që e sollën për herë të parë këtë shkrimtar kalibri në gjuhën shqipe. I lindur në Trinidad nga prindër prej Indise, V S Naipaul, adaptoi Anglinë si atdheun e tij të dytë dhe e bëri Anglishten gjuhën e tij të parë. Romanet dhe librat e tij me mbresa udhëtimeve hyjnë ndër gjërat më magjepsë të letërsisë moderne. Temperament magmatik, i njohur për shpërthimet e papritura kundër vulgaritetit të kulturës sipërfaqësore, shpesh kishte periudha të gjata melankolie, kohë kur e brente dyshimi për kotësinë e shkrimit të librave. V.S. Naipaul, konsiderohet një prej shkrimtarëve më të rëndësishëm të shekullit XXI, fitues i çmimit “Nobel” në letërsi në vitin 2001.

Qyteti bri lumit, është një lloj

autobiografie e një shkrimtari që la vendin e tij Indinë, për t’u shkolluar e më pas për t’u bërë një nga autoritetet e mendimit në Britaninë e Madhe. Është një përplasje e kulturave, mentaliteteve, botëve të vjetra që kanë dominuar fatet e njerëzimit. Ky libër është një manual për ndryshimin, për atë ndryshim që shpesh dhemb, por që është i domosdoshëm në shumë shoqëri. Libri shoqërohet në shqip me një parathënie nga kritikja dhe shkrimtarja e njohur angleze Elizabeth

Hardwick. “Qyteti bri lumit” është historia e një trazire historike dhe e një kolapsi social. Përplasja e kulturave në Indi, vendet islamike, Afrikë, Amerikë e Jugut dhe ishujt Karaibe janë burimet që Naipaul përdor për imagjinatën e tij krijuese, në letërsinë artistike dhe në librat e tij të udhëtimeve nëpër botë, udhëtime këto aq të ngadalta në kohë, e aq personale, sa që nuk mund të klasifikohen dot si libra udhëtimi.

Ngjarjet zhvillohen në periudhën postkoloniale, në kohën e

pavarësisë. Europeanët janë shpërngulur nga aty, ose janë detyruar të shpërngulen, dhe skena është kaotike, gjithë dhunë, me luftime mes fiseve, injorancë e plotë, izolim, varfëri dhe një mungesë përgatitjeje për botën e re, në të cilën ata kanë hyrë, ose pjesërisht e supozuar si një lloj dekorimi. Siguria e verbër e administratës koloniale, me rregullat e saj, komercializimin e resurseve të disponueshme, me bulevardet e saj dhe me shtëpitë e bukura, e klubet për argëtimin e të ardhurave të huaj, çoi në bumin e shumë shteteve, që sapo e kishin fituar pavarësinë.

Këtu aktualisht pushteti është në duart e presidentit, një luftëtar fisnor i kërcënuar nga ambicjet e luftëtarëve të fiseve të tjera. Libri është një akuzë për pushtet e dhunshme, përmes një personazhi që nuk nguron të përshkruajë dhe presidentin e vendit të tij. “Te ‘Qyteti bri lumit’ zvarritja, korrupsioni mbytës dhe shkatërimi që e shoqëron ardhjen në pushtet të forcave fisnore, ose dhe komplotimin e tyre për të

marrë pushtetin, pasiguria e zbatimit të marrëveshjeve, pakënaqësia e turmave të vendasve që vuanin për një kohë të gjatë, e që e përhapnin edhe në qytet këtë pakënaqësi: e gjitha kjo është panorama në të cilën zhvillohet romani.

Pjesë e tij janë tregtarë indianë dhe pronarë të një biznesi apo të një tjetri, një çift europianësh të bardhë, një prift plak, belg, që ka shumë vite që jeton aty dhe afrikanë të shumtë, në kërkim të mundësive të reja. Romani është një ndërmarrje me disa rreziqe dhe pa rreziqe, të cilin Naipauli, i ka dhënë formën e një veprë të kryer, me një forcë imagjinuese, fort të gjallë”, thotë Elizabeth Hardwick. Përtej letërsisë së tij, e cila vijon të botohet çdo vit në çdo vend të botës, Naipaul është një shkrimtar që tërheq vëmendjen dhe me karakterin e tij. I quajtur “shkrimtari i errësirës”, mediat shohin një anë të errët dhe në raportin që ai ka pasur me të shoqen, me të cilën jetoi 41 vjet, anglezen Patricia Ann Hale, me të cilën u njoh gjatë një vizite në Spanjë në vitin

1952. Ata studiuuan bashkë në Oksford dhe u martuan në Londër më 1955.

Martesa e tyre zgjati 41 vjet, deri në vdekjen e Pat, ashtu si e thërrisnin miqtë e saj. Bashkëjetesa e tyre nuk ka qenë e lehtë dhe shpesh çifti ka qenë në qendër të medias, pas deklaratave të Naipaul se nuk mund “t’i shmangte dot prostitutat”, apo pas marrëdhënies së gjatë që ai ka pasur në të njëjtën kohë me Margaret Gooding.

Ka pasur akuza në media mbi rolin që Naipaul ka pasur mbi vdekjen e Pat, pavarësisht se ajo vuante prej kohësh, pas gjetjes së shënimeve të saj mbi faktin që Naipaul ishte shpesh dhe i dhunshëm. Te “Qyteti bri lumit”, ne kemi pasazhe dhune, në një apartament në Londër, nga një çift dashnorësh, të ndarë mes pasionit dhe së vërtetës... Ndoshta ajo çfarë ka shkruar, forca për të dhënë dhimbjen deri në skajin e saj, e bën këtë autor nga më të rëndësishmit e shekullit XXI, të jetë shpesh dhe në qendër të këtyre akuzave, që mbeten thjesht të tilla.





# V.S Naipaul, historia e një jete jo të zakonshme



Vidiad-har Suraxhprasad Naipoli (Vidiadhar Surajprasad Naipaul), një prej shkrimtarëve më të rëndësishëm të anglishtes së sotme, lindi në Trinidad, nga prindër indianë, më 17 gusht 1932. Gjyshi i tij ishte një induist nga veriu i Indisë, që emigroi në ishujt Karaibe, si një punëtor me kontratë. I ati ishte gazetar dhe ai e frymëzoi Naipolin e ri për atë që do të ndiqte më vonë. “Në të vërtetë, që prej një moshe fare të hershme, e mendoja veten si shkrimtar... për shkak të idesë së pazezistueshme të këtij profesioni fisnik”, – kujton ai.

Në vitin 1938, familja u vendos në qytetin e Portit të Spanjës, ku Naipoli ndoqi shkollën fillore dhe të mesme. Në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare, emigroi në Angli, me një bursë për në kolegjin universitar të Oksfordit. Pasi arriti të merrte diplomën për letërsinë angleze, në vitin 1953, ai shkoi në Londër për të punuar si redaktor për Caribbean Voices-in, një program radioje i BBC-së, që transmetohej në Indinë Perëndimore. Karriera e tij si shkrimtar pati një fillim të mbarë me botimin e

romanit Masazheri misterioz, në vitin 1957.

Një roman pikaresk, rreth një njeriu kontradiktor, i cili u bë burrë shteti në Trinidad. U nderua me çmimin John Llewellyn Rhys Memorial. Urata e Elvirës (1958) dhe Rruga “Migel” (1959), një përmbledhje me tregime që fitoi çmimin Somerset Maugham, pasqyrojnë gjithashtu idiotësitë e shoqërisë në Indinë Perëndimore.

Botimi i Një shtëpi për Z. Bisuas (1961), një roman tragjikomik që të kujton Dikensin, ishte një kthesë e madhe në veprën e Naipolit. E respektuar gjerësisht si kryevepra e tij, ky roman është një raport imagjinar i jetës së të atit, i cili bën një jetë të dyfishtë dhe me këtë simbolizon vuajtjet në periudhën koloniale. Z. Ston dhe shoqëria e kalorësve (1963), romani i tij i parë, ngjarjet e të cilit vendosen në Angli, e bëri të fitonte çmimin Hawthornden.

Naipuli e filloi serinë e veprave të tij rreth kombeve afrikane që kishin ardhur në ekzistencë nëpërmjet pavarësive të tyre

politike, duke e përshkruar botën e pas periudhës koloniale me Kalimin e mesit (1962). E hartuar në formën e kujtimeve të udhëtimeve, kjo vepër shpreh pikëpamjet e shoqërisë britanike, franceze dhe holandeze të Indisë Perëndimore dhe të Amerikës së Jugut. Pas një udhëtimi njëvjeçar nëpër Indi, ai shkroi Një rajon i errësirës (1964), një portretizim kontradiktor i atdheut të të parëve të tij. Më vonë, Naipoli bëri një gërshetim mes përshkrimit artistik dhe atij joartistik, në lidhje me identitetin kulturor. Në vitin 1967, ai botoi romanin shumë të rëndësishëm, Imituesit, një vepër rreth pasojave të imperializmit britanik, i cili bëri që të fitonte çmimin W. H. Smith, dhe Një flamur në ishull, një përmbledhje e dytë me tregime.

Në vijim ai përshkoi origjinën e Trinidadit të sotëm, me elementë të shumtë personale, te Humbja e El Dorados (1969). Në një shtet të lirë, një vepër novatore që u referohej emigrantëve britanikë në një vend afrikan me konflikte të shumta, u nderua me çmimin prestigjioz të

Anglisë, Booker, në vitin 1971. Barrakuni i mbipopulluar dhe artikuj të tjerë është një kompilim i gazetarisë personale dhe politike, i cili doli në qarkullim vitin e ardhshëm. Botimi i Guerilja (1975), një roman gjuetie njerëzore, vrasjesh e revolucioni në një ishull të Karaibeve, të çliruar së fundi nga sundimi kolonial, e përforcoi ndjeshëm reputacionin e Naipolit në Shtetet e Bashkuara.

Pasi e rivizitoi Indinë, gjatë kohës së emergjencës (1975), ai solli një tjetër vështrim të kontinentit të vogël me veprën India: Një qytetërim i plagosur (1977). Në vitin 1979, ai botoi Qyteti te kthesa e lumit, një përshkrim i thellë që rrëmon po aq thellë, çështjen e shpërnguljeve në një epokë neokoloniale. Gjatë viteve '80, Naipoli u përqendrua kryesisht tek letërsia joartistike. Ai shkroi një sërë trajtesash të shkurtra: Kthimi i Eva Peronit dhe vrasjet në Trinidad (1980), Mes besimtarëve: Një udhëtim rreth rilindjes islamike në Iran, Pakistan, Malajzi dhe Indonezi; dhe Duke gjetur qendrën – dy

rrëfime (1984), një trajtesë autobiografike dhe një trajtesë rreth Bregut të Fildishtë.

Enigma e mbërritjes (1987), romani i tij i vetëm i asaj dekade, është ndoshta më autobiografiku i tij. Veç kësaj, ai shkroi Një kthim në Jug (1989), shënime rreth udhëtimeve të tij nëpër Amerikën e Jugut. Në vitin 1990, ai u shpall kalorës prej mbretëreshës Elizabetë II. Në të njëjtin vit, ai botoi India: Një milion kryengritje tani, një vizion më optimist i këtij kombi për ditët e sotme. Në vitin 1993, ai u nderua me çmimin britanik për letërsinë David Cohen.

Romani më i fundit i Naipolit, Një rrugë në botë (1994), është një gërshetim i elementëve autobiografikë dhe përsiatjes, një rrëfenjë madhështore e rikthimit në identitet. “Për begatinë e tij origjinale, vështirë se ka ndonjë shkrimtar të gjallë që ia tejkalon V. S. Naipolit, – shkroi The New York Times Book Review-ja. – Ai është shkrimtari i botës, një mjeshtër i gjuhës dhe i perceptimit”.

(gazeta-Shqip.com)



## Erdogani: Do të krijojmë më shumë zona të sigurta në Siri

ANKARA, 12 GUSHT - Turqia ka përfunduar përgatitjet për të krijuar më shumë zona të sigurta brenda Sirisë, ashtu siç ka bërë në të kaluarën me dy sulme ushtarake në pjesën veriore të vendit, në kufi me Sirinë, tha presidenti

turk Rexhep Tajip Erdogan. Duke folur në selinë e partisë së tij, në qytetin Trabzon, Erdogani tha se çerek milioni njerëz tashmë janë kthyer në zonat e çliruara në Siri, raporton "Reuters". Presidenti turk Erdogan tha se

përpjekjet diplomatike dhe ushtarake në provincën siriane Idlib, kanë përshpejtuar shmangien e një "katastrofe", si ato që kanë ndodhur në pjesë të tjera të Sirisë. Lufta civile në Siri ka nisur në

mars të vitit 2011, fillimisht me shtypjen e protestave të opozitës. Që atëherë, në Siri kanë vdekur mbi 350 mijë persona. Si pasojë e konfliktit, miliona sirianë janë detyruar të zhvendosen nga shtëpitë e tyre.



# Protesta në përvjetorin e mitingut të nacionalistëve të bardhë në ShBA

Të shtunën në mbrëmje në qytetin e Charlotsvillit u zhvilluan në mënyrë paqësore marshime dhe aktivitete të tjera të komunitetit, në praninë e një numri të madh trupash policore. Policia kishte vendosur barriera betoni dhe pika kontrolli për kalimtarët

UASHINGTON, 12 GUSHT - Ndërsa zyrtarët në qytetin amerikan Uashington dhe në shtetin fqinjë, Vixhinia, marrin masa për përvjetorin e parë të një mitingu të nacionalistëve të bardhë, që përfundoi në dhunë vdekjeprurëse, presidenti Donald Trump bëri thirrje për bashkim. "Duhet të qëndrojmë së bashku si komb. Unë dënoj çdo lloj racizmi dhe veprime me dhunë. Paqe për të gjithë amerikanët!", shkroi në Twitter presidenti, ndërsa ndodhet në klubin e tij të golfit në shtetin e Nju Xhërsit.

Trumpi shtoi se ai "ka luftuar" për përmirësimin e jetës për të gjitha pakicat dhe u zotua se "Nuk do të pushoj kurrë së luftuari për të gjithë amerikanët!"

Përgjigjja e presidentit ndaj mitingut të vitit të kaluar në Sharlotsville të Vixhinas, shkaktoi kritika të mëdha kur ai deklaroi

nga dhoma e konferencave për shtyp të Kullës Trump, se "të dyja palët në miting ishin njerëz normalë."

Të shtunën në mbrëmje, në qytetin e Charlotsvillit u zhvilluan në mënyrë paqësore marshime dhe aktivitete të tjera të komunitetit, në praninë e një numri të madh trupash policore.

Policia kishte vendosur barriera betoni dhe pika kontrolli për kalimtarët. "Vitin e kaluar policia nuk u tregua e aftë, ose nuk mori vendimet e duhura për të zbatuar ligjin. Këtë vit është shumë ndryshe. Policia e shtetit të Vixhinas është e pranishme në mënyrë masive dhe ata e kanë nën kontroll situatën", thotë një banor i Sharlotsvillit.

Në kampusin e Universitetit të Vixhinas të shtunën në mbrëmje pati një tensionim të gjendjes për shkak të thirrjeve të një grupi



demonstruesish dhe një konfrontim mes tyre dhe policisë, por pas vetëm disa minutash, situata u qetësua. "Kam 10 vjet që jetoj në Charlottesvill. Jam student i mjekësisë. U shqetësova për shkak të masave të pakta të administratës vitin e kaluar. Duke dashur të përfaqësoj shkollën dhe shokët e mi të klasës, them se ne jemi kundër supremacisë të bardhë

dhe kundër asaj që ndodhi vitin e kaluar", thotë një student i Universitetit të Vixhinas. Mbrëmja e së shtunës shënoi përvjetorin e parë të marshimit me pishtarë në duar të supremacistëve të bardhë, në kampusin e Universitetit të Vixhinas. Të nesërmen pati një miting me pjesëmarrjen e shumë njerëzve në qendrën e qytetit të Sharlotsvillit.

Më 12 gusht 2017, qindra nacionalistë të bardhë, në mesin e tyre neonazistë, elementë ekstremistë dhe anëtarë të organizatës Ku Klux Klan, u mbledhën në Sharlotsvill, mes të tjerash për të protestuar kundër vendimit të zyrtarëve të qytetit për heqjen e monumentit të gjeneralit të Konfederatës Robert E. Lee nga një park.

## Të shtëna me armë në Mançester, 10 persona të plagosur

LONDER, 12 GUSHT - Policia britanike njoftoi se dhjetë persona përfunduan në spital në Mançester, gjatë orëve të para të së dielës. Në orën 2:30 pas mesnate policia u njoftua për të shtëna me armë në rrugën Claremont, në lagjen Moss Side të qytetit Mançester. Policia nuk bëri të ditur moshën e viktimave që po trajtohen në spital për një sërë plagësh të vogla dhe të mëdha. Një ditë më parë, qyteti shijoi një atmosferë pozitive me organizimin e Karnavalit të



Karaiëve. Lagja Moss Side është një ndër zonat më të varfra në Britani, ku deri në mesin e

viteve 2000 pati një nivel të lartë përplasjesh me armë mes bandave.

## Kryeministri irakian, Haider al-Abadi, anulon vizitën në Iran

BAGDAD, 12 GUSHT - Kryeministri irakian Haider al-Abadi anuloi vizitën në Iran, parashikuar për të mërkurën, për shkak të agjendës së ngarkuar dhe do të shkojë vetëm në Turqi, theksoi të dielën zyra e tij e shtypit. Një ditë më parë, një zyrtar politik irakian, njoftoi për këtë vizitë të dyfishtë, të martën në Turqi dhe të mërkurën në Iran duke theksuar se diskutimet me dy fqinjët do të kishin krye-



sisht karakter ekonomik. "Abadi nuk do të shkojë në Iran sepse axhenda e tij është e ngarkuar", theksoi zyra e shtypit e kryeministri irakian pa dhënë shumë detaje.

## Vijojnë protestat në Rumani, mbi 450 të plagosur

BUKURESHT, 12 GUSHT - Mijëra protestues kanë dalë sërish në rrugët e Bukureshtit për të kërkuar dorëheqjen e Qeverisë rumune të socialdemokratëve. Shumë rumunë që jetojnë jashtë vendit janë kthyer në shtëpi për t'iu

bashkuar protestave. Mbi 450 persona raportohet se janë lënduar për shkak të protestave, të cilat duken se nuk do të ndalen deri në arritjen e qëllimit. "Na duhet ndryshim. Duhet t'i ndryshojmë politikanët, qeverinë,

sepse të gjithë ata janë të paafte të bëjnë diçka të mirë për ne. Ata mendojnë vetëm për veten e tyre. Nuk do të dorëzohemi derisa diçka të ndryshojë, derisa ata të na japin shansin për një jetë më të mirë", thotë një

protestuese. Socialdemokratët në Rumani kanë hedhur poshtë apelet për zgjedhje të reja, duke thënë se protestat nëpër rrugë nuk duhet të lejohen të rrezojnë qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike.





E rrallë

# 1 400 armë dhe 1 200 shpata gjenden të groposura në shkollë

Rreth 1 400 armë zjarri dhe 1 200 shpata që besohet të jenë nga periudha e Luftës së Dytë Botërore janë zbuluar javën që lamë pas të groposura në një shkollë fillore në Tokion perëndimore. Granata, plumba dhe armë u gjetën në thellësi deri në dy metra poshtë bazës së Shkollës Fillore "Tanashi" në qytetin Nishitokyo.



## BARSOLETA E DITËS



I thotë biondja shoqes së bionde:  
"Paramendo, dje u ndal rryma, mbeta në ashensor një orë rrafsh!"  
"Po kjo nuk është asgjë. Unë kam mbetur tri orë në shkallët lëvizëse".



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

#### "INCREDIBLES 2" 3D


I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird



## FOTO E DITES



Një pamje nga qielli tregon njerëzit në një plazh në brigjet e liqenit Silbersee në Haltern të Gjermanisë. /Reuters/


Në ora 18:20

#### "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco



Në ora 20:00

#### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed



Në ora 22:00

#### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: **Kino ABC**.

## E jashtëzakonshme

# Deputeti hyn në parlament si Hitleri

Naramalli Sivaprasa, një deputet indian, nuk është i ri për iniciativat provokuese. Gjatë viteve politikani është paraqitur në parlament i veshur si një fermer, si një fetar dhe një grua, për ta shprehur mospajtimin e tij mbi tema të ndryshme. Sivaprasa së fundmi ka hyrë në parlament në Nju Delhi i veshur si Adolf Hitleri, për ta shprehur kundërshtimin ndaj kryeministrit Narendra Modi, duke kërkuar më shumë fonde për zhvillimin e zonës së Indisë jugore.



 <p><b>DASHI</b> Vendosni pak rregull në ditën tuaj sot dhe programoni ato që do të bëni. Dëshironi të rri në shtëpi dhe ta shijoni ditën me njerëzit e dashur.</p>	 <p><b>DEMI</b> Sot do të veproni sipas asaj që ju thotë zemra, pavarësisht prej këshillave që do t'ju japin miqtë. Një ndjenjë e re paraqitet në horizont.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Dikush po mendon shumë për ju sot. Fati është në anën tuaj, kështu që mund të veproni si në karrierë dhe në dashuri.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Nervozizmi dhe tensioni sot do ta shoqërojnë ditën tuaj. Në raportin në çift ka diçka që ju shqetëson juve dhe partnerin.</p>	 <p><b>LUANI</b> Keni qenë shumë të ngarkuar me punë gjatë kësaj periudhe. Vendosni të bëni disa ditë pushim që do t'ju qetësojnë shumë.</p>	 <p><b>VIRGJËRISHA</b> Nuk është momenti ideal për të kërkuar borxh ose për të marrë kredi. Disa probleme financiare në të ardhmen do t'ju shqetësojnë.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Sot një këngë do t'ju ëngjall kujtime shumë të bukura. Po ndjeni nostalgji për një person që ka qenë i rëndësishëm në jetën tuaj.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Optimizmi juaj sot do të jetë ngjites. Në ambientin ku jeni do të ketë shumë humor dhe alegri. Çdo gjë do të kalojë këndshëm.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Dita ideale për të mësuar gjëra të reja. Do të jeni në zbulim të vetvetes dhe kjo gjë do t'ju bëjë njerëz më të mirë.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Jeni duke pritur personin e duhur në jetën tuaj. Shikoni përreth sepse mund të jetë shumë më pranë nga sa mendoni.</p>	 <p><b>UJORI</b> Sot nuk duhet të tregoni shumë gjëra nga vetja tek persona që sapo i keni njohur. Mund t'i keqpërdorin në të ardhmen.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Nëse keni tradhtuar një mik, sot është dita kur kjo gjë do të zbulohet. Nuk do të mund të rregulloni dot gjërat që tashme janë thyer.</p>



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**Sport**



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82



PROGNOZA SPORTIVE

MUNSTER - LOTTE

3+

HAUGESUND - VALERENGA

1

FRANKFURT - MANNHEIM

GG

Sot (e hënë) me ndeshjen e Superkupës edhe zyrtarisht hapet stadiumi "Fadil Vokrri"

# MKRS-ja dhe FFK-ja: Ejani ta nderojmë legjendën Fadil Vokrri



Ministria e Sportit dhe Federata e Futbollit po dëshirojnë që përirimi i stadiumit "Fadil Vokrri" të bëhet në mënyrë sa më madhështore, prandaj i kanë ftuar tifozët dhe qytetarët të jenë në numër sa më të madh. "Nëse ka individ që duhet të falënderohet në Kosovë për këtë vepër është i ndjeri Fadil Vokrri", ka thënë ministri Kujtim Gashi

ruajmë këtë pasuri, sepse kemi investuar si Qeveri e Kosovës dhe kemi qenë jashtëzakonisht të përkushtuar që stadiumi t'i plotësojë të gjitha kriteret e kërkuara nga UEFA. Është lojë testuese, por shumë e rëndësishme për sportin në Kosovë, se mund ta marrim dritën jeshile që në këtë

stadium të zhvillohen edhe ndeshjet e tjera", ka thënë ministri Gashi, i cili më pas ka falënderuar legjendën tashmë të ndjerë, Fadil Vokrrin, për punën e bërë në rregullimin e këtij stadiumi. "Nëse ka individ që duhet të falënderohet në Kosovë për këtë vepër është i ndjeri Fadil Vokrri", ka thënë Gashi.

Numri një i MKRS-së e vlerësoi hapjen e stadiumit si një moment historik: "Të hënën do ta shënojmë njërën prej ngjarjeve më të rëndësishme në Kosovë. Ky është një moment sa emocional aq edhe krenar për të gjithë neve që kemi qenë të përfshirë në këtë proces. Ky është një investim i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, një përpjekje e jona e vazhdueshme për ta avancuar infrastrukturën sportive në vend".

Më herët edhe kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka ftuar qytetarët të jenë të pranishëm në numër sa më të madh në përirimin e stadiumit "Fadil Vokrri". "Kjo është një ndeshje testuese dhe do të organizohet sikur të ishte ndeshje ndërkombëtare. U bëj thirrje qytetarëve të jenë në numër sa më të madh në stadium, pasi do të kenë mundësi ta shohin tërë atë mrekulli që është bërë në stadium dhe do të jenë tepër komodë për ta kaluar një mbrëmje afër futbollit. Në këtë ndeshje do të bëhet testimi nga inspektorët e UEFA-s, të cilët, më pas, nëse jepet drita e gjelbër, do të dorëzohet edhe certifikata tek pronari i stadiumit që është Komuna e Prishtinës", ka deklaruar Ademi.

## FFK-ja: Nuk do të tolerohet falsifikimi i fanellave të kombëtares

PRISHTINË, 12 GUSHT - Federata e Futbollit e Kosovës dënon ashpër daljen në treg të kopjes së fanellave të reja të Kombëtares së Kosovës. FFK-ja nëpërmjet një njoftimi për medie sqaron opinionin se falsifikimi i tillë nuk do të tolerohet dhe do të dënohet sipas ligjeve në fuqi të Kosovës, prandaj kërkon nga personat që i kanë hedhur këto fanella në shitje nëpërmjet "Facebook"-ut, t'i tërheqin ato sa më parë. FFK-ja, po ashtu, do ta paraqesë rastin në prokurorinë e shtetit dhe tek agjencia e të drejtave autoriale. Tash për tash fanellat e kombëtares së Kosovës janë në shitje vetëm në faqen zyrtare të kompanisë "Fourteen".



### SHKURT

#### Dajaku vazhdon me Drenicën

Taulant Dajaku ka arritur marrëveshje me Klubin e Drenicës edhe për sezonin e ri. Mesfushori me përvojë do të nënshkruajë sot (e hënë) kontratën me klubin kuqezi. Lajmi është zyrtarizuar nga faqja e Drenicës në "Facebook". "Pas bisedave në mes të drejtorit sportiv, Tahir Lushtakut dhe mesfushorit drenicas, Taulant Dajakut, përfundimisht është arritur pajtimi mes palëve dhe futbollisti do ta firmosë të hënën kontratën", thuhet në njoftimin e Drenicës.

#### Shaqiri debuton për Liverpoolin

Futbollisti shqiptar Xherdan Shaqiri ka debutuar në ndeshje zyrtare për skuadrën e Liverpoolit. Kjo e fundit shënoi fitore 4-0 në ndeshjen ndaj West Ham Unitedit në Premierë Ligë, kurse Shaqiri është inkuadruar në lojë në minutën e 80 në vend të Sadio Mane.

#### Zhegrova, titullar në fitoren e Genkut

Reprezentuesi i Kosovës, Edon Zhegrova, ishte titullar në ndeshjen që Genku e fitoi ndaj Oostendes (2-0). Talenti shqiptar luajti deri në minutën e 64-t, kurse u zëvendësua me Dieumerci Ndongala. Skuadra e Zhegrovës aktualisht zë vendin e dytë në elitën e futbollit të Belgjikës.

#### Kuka mposhtet në Budapest

Ka përfunduar pjesëmarrja e xhudistëve të Kosovës në Çmimin e Madh të Xhudos që është mbajtur në Budapest të Bullgarisë. E fundit që garoi në këtë Grand Prix ishte xhudistja Lorian Kuka në kategorinë deri në 78 kg. Ajo i fitoi pikët e para olimpikë për Tokyo 2020, pasi triumfoi në luftën e parë, por u mposht në të dytën. E nisi shumë mirë pjesëmarrjen duke arritur të fitojë në luftën e parë ndaj xhudistes nga Venezuela, Karen Leon, ndaj së cilës Kuka doli triumfuese me Ippon. Por, ishte e pafat në luftën e dytë dhe u eliminua nga gara, pasi më e suksesshme se xhudistja pejane ishte japonezja Mami Umeki që fitoi me Ippon. Në këtë garë, pjesëmarrëse ishte edhe Distria Krasniqi e cila të premten fitoi medaljen e bronzit.

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 GUSHT - Stadiumi "Fadil Vokrri" do të hapet sonte (e hënën) me ndeshjen finale të Superkupës, Prishtina - Drita. Ministri Kujtim Gashi në konferencë për medie, një ditë para ndeshjes, ka bërë thirrje që sa më shumë shikues të jenë të pranishëm të hënën në stadiumin "Fadil Vokrri". "I ftoj të gjithë sportdashësit dhe qytetarët të jenë në stadium dhe të festojmë në këtë ngjarje të madhe sportive, në këtë stadium që i plotëson kriteret e UEFA-s. U bëj thirrje 'Dardanëve', 'Plisave' dhe tifozëve të tjerë që të festojmë dhe ta



## Fitore drithëruese e Lorenzos në Austri

VJENË, 12 GUSHT - Fitore drithëruese e Jorge Lorenzos në Çmimin e Madh të Austrisë. Piloti i Ducatit arriti ta mposhtë Marc Marquezin e Hondas për vetëm 130 të mijtat, pas një beteje epikë e parakalime të shumta, por në

fillim të xhiros së fundit spanjoli i Ducatit e ruajti deri në fund kryesimin, duke fituar pikë shumë të rëndësishme në klasifikimin e përgjithshëm. Andrea Dovizioso i gëzohet vendit të tretë, ndërsa i katërti doli Cal

Crutchlow. Tri xhirot e fundit ishin të jashtëzakonshme, ku herë kryesonte Lorenzo e herë Marquezi, që nuk e ulën gazin deri në metrin e fundit. Por piloti i Ducatit u tregua më i saktë në kilometrat e fundit, duke mposhtur me pak cen-

timetra diferencë shokun e ardhshëm të skuadrës. Meritoi duartrokitjet e të pranishmëve në Çmimin e Madh të Austrisë edhe Valentino Rossi që, pavarësisht se u nis nga vendi i 14-t, e mbylli garën i gjashti.



# Rashica: Dua të bëhem një idhull për fëmijët e Kosovës



BREMEN, 12 GUSHT - Milot Rashica u transferua për 7.5 milionë euro nga Vitesse Arnheim te Werder Bremeni. Në një intervistë për "Bild", sulmuesi anësor flet për vendlindjen, të dashurën dhe fenë. "Për mua ka qenë një hap i madh, kur para tre vjetësh erdha nga Kosova në Holandë. Nuk ka shumë lojtarë nga vendi im që luajnë në njërin nga top pesë ligat e botës. Për këtë të arritur ne duhet të jemi krenarë. Dua të bëhem një idhull për fëmijët e Kosovës", ka thënë Rashica.

**Rashica, ju keni ardhur gjatë janarit te Bremeni, por nuk dimë shumë për ju...**

**Rashica:** Jam një tip shumë normal. Pas përgatitjeve, zakonisht jam në shtëpi me të dashurën time (Belkiz Kera). Ajo më ka mbështetur shumë. Me të mund të flas për gjithçka. Mbi të gjitha, ajo është një kuzhinierë tepër e mirë.

**Dhe a keni ndonjë ushqim të preferuar gjerman?**

**Rashica:** Orizin me qumësht! Edhe në vendlindjen time është një ushqim tradicional. Por atje e hamë të ftohtë.

**Sa ju mungon shtëpia?**

**Rashica:** Për mua ka qenë një hap i madh, kur para tre vjetësh erdha nga Kosova në Holandë. Nuk ka shumë lojtarë nga vendi im, që luajnë në njërin nga top pesë ligat e botës. Për këtë të arritur ne duhet të jemi krenarë. Dua të bëhem një idhull për fëmijët e Kosovës.

**Si është futbolli në Kosovë?**

**Rashica:** Në tre vjetët e fundit

është bërë shumë. Janë ndërtoar stadione të reja dhe ka shumë sponsorë që përkrahin klubet. Sa isha unë, kjo ka qenë më e vështirë. Atëbotë Kosova nuk ishte pjesë e UEFA-s dhe FIFA-s. Nuk kisha mundësinë të luaja në kombëtare sikur tani.

**Dhe, megjithëkëtë, ju keni arritur deri në Bundesliga...**

**Rashica:** Për këtë e falënderoj shumë familjen time. Ajo gjithnjë është përkrah meje dhe më mbështet. Kur isha fëmijë, babai im gjithnjë më ka dërguar në përgatitje me makinë. Ai është dentist dhe kishte shumë punë. Por këtë e bënte me qejf. Sot familja ime nuk e humbet asnjë ndeshje timen. Është shumë krenare me mua.

**Sa është e rëndësishme feja për ju?**

**Rashica:** Shumë e rëndësishme. 90 për qind e kosovarëve janë myslimanë. Unë mendohem t'u përmbahem rregullave të religjionit aq sa mundem. Nuk ha mish të derrit dhe nuk konsumoj alkool, po ashtu falem e lutem shumë. Megjithatë, muajin e Ramazanit nuk mund ta agjëroj tërësisht, pasi bëj edhe jetë sportisti.

**Si po ju shkojnë përgatitjet me Werderin?**

**Rashica:** Po ndihem shumë mirë. Dimrit nuk mund t'i realizoja mirë, pasi erdha vonë. Dhe këtë e vërejtta në sezonin pranveror. Tani jam kondicionalisht në të njëjtin nivel si të tjerët, punoj çdo ditë me djemtë e tjerë dhe jam shumë i angazhuar.

**Në sezonin e kaluar ju ishit vetëm pesë herë në ekipin e parë. Pritnit më shumë?**

**Rashica:** Muajt e parë ishin shumë të vështirë për mua. Më duhej pak kohë për t'u përshatur. Dallimi midis ligës së Holandës dhe Bundesligës është shumë i madh. Ritmi është i lartë në ndeshje, stadiumet janë më të mëdha dhe përgatitjet më intensive. Më duhej të punoja shumë në anën taktike, sidomos në mbrojtje. Në fund të sezonit e arrita një gjë të tillë, madje mirë.

**Çfarë synime i keni vënë vetes për sezonin e ri?**

**Rashica:** Dua ta ndihmoj ekipin me gola e asistime. Kam punuar shumë në përgatitje dhe jam munduar ta bindi trajnerin. Dua të luaj, edhe pse kemi një konkurrencë tepër të fortë në pozitë e anësorëve. Nuk jam asnjëherë i qetë dhe dua ta provoj veten deri në kufijtë e mi. Në fund, është trajneri ai që vendos kush luan.

**Cilat janë gjasat tuaja kundër Wormsit për ekipin e parë?**

**Rashica:** Unë jam shumë i përgatitur. Do të më pëlqente shumë nëse do të isha në ekipin e parë. Pavarësisht a do të luaj në krahun e majtë apo të djathtë, por prapë në fund është vendimi i trajnerit.

**Dhe ju jeni më i shpejti i ekipit apo?**

**Rashica:** Këtu janë disa lojtarë të shpejtë në ekip. Nuk e di a jam unë më i shpejti. Së paku mua më thonë bashkëlojtarët se jam raketë (qeshet).

## SHKURT

### Pogba: Unitedi më dënon nëse e flas të vërtetën

Paul Pogba ka bërë me dije se nuk mund t'i thotë të gjitha të vërtetat për faktin se skuadra e Manchester Unitedit mund ta dënojë. "Nëse nuk je i lumtur, nuk mund ta japësh maksimumin në fushë. Ka disa gjëra që nuk mund t'i them, pasi mund të më dënojnë. Diferenca mes kombëtares dhe Unitedin? Unë ndihem mirë në fushë kur luaj me të dyja ekipet. Jam gjithnjë i njëjti, por kur je i qetë mendërisht dhe ke një mjedis që të përkrahë, gjërat janë më të lehta në fushë", ka deklaruar Pogba.

### Gashi fiton ndaj Hykës në derbin shqiptar në Amerikë

Shkëlzen Gashi ka arritur të marrë një fitore të rëndësishme me ekipin e tij Kolorado Rapids. Përballë ata kishin San Hozen, ekipin ku aktivizohet shqiptari tjetër Jahmir Hyka. Ky i fundit e ka filluar ndeshjen si titullar dhe është zëvendësuar në minutën e 67. Ndërkohë, Gashi ka hyrë në fushë në minutën e 62-të. Takimi ka përfunduar me rezultatin 2-1 në favor të Kolorado Rapids. Golat janë shënuar nga Smith dhe Boateng për ekipin e Gashit. Boatengu ka shënuar në minutën e 93-të për t'i dhënë fitoren ekipit të tij. Erksen ka barazuar përkohësisht me 11-metërsh për San Hozen.

### Milanit nuk i mjafton vetëm Higuaini

Trajner Gennaro Gattuso, pas humbjes nga Real Madridi (3-1), ka thënë se skuadrës së Milanit nuk i mjafton vetëm sulmuesi Gonzalo Higuain. "Qëkur erdhi në ekip e kam parë me sjelljen e duhur, por vetëm me Gonzalon nuk arrijmë gjëkundi", ka thënë Gattuso.

### Torino e refuzon Napolin për Belottin

Skuadra e Napolit ka bërë një ofertë gjatë kësaj jave në drejtim të Torinos për sulmuesin italian Andrea Belotti, por ajo është refuzuar. Napoli njoftohet se ka ofruar 30 milionë euro plus shërbimet e Roberto Ingleses me qëllim që ta marrë Belottin, por kjo nuk ka mjaftuar, pasi është refuzuar nga Torino që dëshiron 60 milionë euro.

### Beshiktashi e kërkon Kariusin

Loris Karius është afër transferimit te skuadra turke Beshiktash, raporton e përditshmja britanike "The Sun". Duket se Karius nuk e bindur më trajnerin Jurgen Klopp, i cili ka vendosur ta shesë dhe të mbajë si portier të dytë Simon Mingolet, ndërkohë që titullar do të jetë braziliani Alisson, që erdhi këtë verë nga Roma. Skuadra turke dëshiron ta transferojë në formë huazimi me të drejtë blerje.

### Mësohet data kur LeBron debuton me Lakersat

LeBron James i dha lamtumirën Cleveland Cavaliersit pas katër sezonesh, ku arriti të fitojë edhe një titull kampion në NBA në vitin 2016. Ylli amerikan i basketbollit iu bashkua skuadrës së Los Angeles Lakersit ku nënshkroi një kontratë katërvjeçare, me një pagë totale prej 154 milionë dollarësh. U hodh edhe shorti për sezonin e ri të NBA-së, ndërsa debutimi i LeBronit me Los Angelesin do të bëhet pikërisht më 18 tetor, në sfidën që Lakersi do ta zhvillojë ndaj Portlandit në transfertë. Tifozët kalifornianë do të duhet të presin 20 tetorin për ta parë yllin 33-vjeçar në parketin e "Staples Center", në sfidën mes Lakersit dhe Houston Rocketsit. Vetëm një muaj më vonë, më 21 nëntor, LeBroni do të rikthehet edhe në "Quicken Loans Arena", ku do të përballlet si kundërshtar me Cleveland Cavaliersin, skuadër për të cilën ka luajtur në katër sezonet e fundit. Kujtojmë se sezoni i ri i NBA-së do të nisë më 16 tetor, ndërsa pretendentëve kryesorë Golden State Warriors dhe Cleveland Cavaliers u është shtuar edhe Lakersi, me praninë e LeBronit në skuadër.



# AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

Prishtinë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada – Government**  
**Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë**  
**Ministarstvo za Inovacije i preduzetništvo/ Ministry of Innovation and Entrepreneurship**

Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme/ Departament za Financije i Opste Sluzbe  
Department of Finances and General Services

Data:10.08.2018

Ref:473/2018

Divizioni i Burimeve Njerëzore

### Njoftim për Anulimin e Konkursit

Anulohet konkursi i publikuar në gazetën "Epoka e Re" me datën 06.07.2018, për pozitën Drejtor i Departamentit Ligjor me nr. të konkursit **APF0003791**. Anulimi i konkursit bëhet pasi që kanë kaluar afatet për caktimin e Komisionit Përzgjedhës për Shërbyesit Civil.

Divizioni i Burimeve Njerëzore

### Obaveštenje za Otkazivanje Konkursa

Otkazivanje (anuliranje) Konkursa objavljenog u novinama "Epoka e Re" na dan 06.08.2017 godine, na poziciji Direktor Pravnok Departmana Broj Konkurs: **APF0003791**. Otkaz tečaja vrši se nakon prekoračenja rokova za imenovanje Izbornog povjerenstva za državne službenike.

Divizija za Ljudske Resurse



An EU funded project managed by the European Union Office Implemented by Dairy EuroLona



### CANCELLATION OF A CALL FOR PROPOSALS

Date : August 13,2018

**Title of contract: Supply of equipment's for the farm and dairy.**

**1. Publication reference**

EuropeAid/150681/DD/ACT/XX – App.82

**2. Date of publication**

June 19,2018, tender no.:03/2018

**3. Programme title**

**From Farm to Table- Quality improvements in the milk and dairy value chain in Euro-Lona Dairy Farm**

**4. Contracting authority**

Euro-Lona SH.P.K dairy farm – Miradi e Eperme , Fushe Kosove

**5. Reason for cancellation**

On the basis of the bids received, for LOT I we have received a reasonable price offer and will be contract awarded , for LOTs II,III and IV the economic operators price offers has exceeded our planning amounts budget lines.

Therefore we have to **Re-tender** partially this tender for LOTs: II, III, and IV.

We would like to thank all economic operators for their participation in this tender, and we hope again for further cooperation.

**Notes:**

Should a new tender procedure be launched for this project, a new contract notice will be published, unless the contracting authority awards the contract through a negotiated procedure – in which case only the award of the contract will be published.

August 2018  
1 e 4 euroLona një

Page 1 of 1

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera për një familje me dy dhoma gjumi. Banesa duhet të jetë e mobiluar bukur dhe është për afat të gjatë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049/472-770.

► Urgjentisht kërkoj banesë për blerje në Fushë Kosovë. Çmimi 25.000-30.000 Euro Tel 044/741-155.

► Lëshoj banesa me qira afër Eulex-it, ish Farmedi, në lagje të spitalit, banesa është e lirë që nga data 01.08.2018. Banesat janë të ndërtuar nga kompania "Cima Contrekshen" njëra banesë ka 112 metër katror ndërsa tjetra 85 metër katror. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 044-923-527 dhe 044-402-679.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera për një person te huaj, Banesa duhet te jete jo shumë larg qendrës, mundësisht tek "Qafa" ose "Tophane" Duhet te ketë dy dhoma gjumi, te jete e mobiluar bukur. Çmimi deri 300 euro. Për info: Tel 049-472-770

► Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perllushi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushë Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.



An EU funded project managed by the European Union Office Implemented by Dairy EuroLona



### CALL FOR EXPRESSION OF INTEREST

PARTIAL RE-TENDER Date : 13 August 2018

**Contract title : Supply of equipment's for the farm and dairy**  
**Publication reference** EuropeAid/150681/DD/ACT/XX –App.82  
**Tender no: 03/2018 - RE-TENDER**  
**Contracting Authority: Euro-Lona SH.P.K.**

Euro-Lona SHPK.intends to award a supply contract for **equipment's for the farm and dairy** in Miradi e EpermeFusheKosove with financial assistance from the Programme of the European Union: **From Farm to Table- Quality improvements in the milk and dairy value chain in Euro-Lona Dairy Farm.**

The tender dossier is available from address:  
**eurolonaproject@gmail.com** and will also be published on local newspaper.

The deadline for submission of tenders is 13 September 2018 at 14:00 hrs – must be at least 30 calendar days after the date of publication of this advertisement.

Possible additional information or clarifications/questions shall be given by Euro-Lona dairy Project Manager through the official E-mail above mentioned.

15 January 2016  
1 e 4 euroLona dy

Page 1 of 1





ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

**ANNOUNCING THE 2017  
QUALITY & SALES AWARDS**

**Quality & Sales Award Recipients**  
*(Listed in alphabetical order)*

- ★ RBC Refreshments Corporation- *Antipolo Philippines*, Quality
- ★ Emisintelladonna Central S.A. *Paraguay*, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Nacionales Salvadoreñas S.A. *Dzatzamala*, Quality
- ★ Fizioli Shtepk. *Kosovo*, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Fuzada Ltda *Brazil*, Quality
- ★ Interbrand S.J.L. *Lebanon*, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. *Czech Republic*, Quality
- ★ Obi Zafal CJSC *Tajikistan*, Quality
- ★ Parlex Sales sales Beverages Ltd. *Bangladesh*, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia *Georgia*, Sales

**RC**  
cola

Coltăţean, România, 1994  
— Since 1994 —